

Kujtimi i konfliktit të armatosur në Maqedoni në vitin 2001:

MODELE TË PËRKUJTIMIT DHE
MEMORIALIZIMIT



Fondi për të Drejtën Humanitare

Kujtimi i konfliktit të armatosur në Maqedoni në vitin 2001:

MODELE TË PËRKUJTIMIT DHE
MEMORIALIZIMIT

Beograd, nëntor 2022



Fondi për të Drejtën Humanitare

Përmbajtja

SHKURTESAT	4
ABSTRAKTI	5
1. HYRJE	7
2. KONFLIKTI I ARMATOSUR NË VITIN 2001	9
2.1. Maqedonia në Jugosllavi: Parahistoria.....	9
2.2. Fundi i viteve të tetëdhjeta dhe fillimi i viteve të nëntëdhjeta.....	10
2.3. Armiqësitë e armatosura.....	12
2.4. Marrëveshja Kornizë e Ohrit.....	15
3. DY KULTURA TË KUJTESËS	19
3.1. Mbrojtësit.....	19
3.2. Fitimtarët dhe martirët.....	23
4. INTERSEKSIONET	26
4.1. Vendet e mosmarrëveshjeve.....	26
4.2. Zonat e kontaktit.....	29
4.3. Përshtatjet etnike.....	32
4.4. Marrëveshja.....	36
5. SHËNIME PËRMBYLLËSE	40
6. LITERATURA	41

Shkurtesat

AKSH	Armata Kombëtare Shqiptare
ASNOM	Kuvendi antifashist i çlirimit popullor të Maqedonisë
AD	Alternativat demokratike
PDSH	Partia Demokratike e Shqiptarëve
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
BE	Bashkimi European
KFOR	Forcat e Kosovës
GJNPJ	Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë
MM	Ministria e Mbrojtjes
KOM	Kisha Ortodokse Maqedonase
MSPMNB	Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
UÇK	Ushtria Çlirimtare Kombëtare
MKO	Marrëveshja Kornizë e Ohrit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
BSDM	Bashkimi Social Demokrat i Maqedonisë
KB	Kombet e Bashkuara
UNPREDEP	Forcat e Shpërndara Parandaluese të OKB
VMRO-DPMNE	Organizata e brendshme revolucionare maqedonase - Partia për Bashkim Kombëtar Maqedonas
URM	Ushtria e Republikës së Maqedonisë

Abstrakti

Ky punim paraqet një analizë të strategjive përkujtimore të konfliktit të armatosur në Maqedoninë e Veriut nga përfundimi i tij zyrtar në gusht 2001 e deri më sot. Analiza tregon se ekzistojnë dy modele dominuese të përkujtimit të vitit 2001 në Maqedoninë e pasluftës që me dy bashkësitë më të mëdha etnike në vend, maqedonase dhe shqiptare. Vëzhgimi i zhvillimeve çdo vit, megjithatë, tregon se praktikrat përkujtimore brenda këtyre dy fushave nuk janë aq uniforme sa mund të duken. Punimi tregon se në dy dekadat e fundit ka pasur ndryshime kritike në diskutet përkujtimore, aktorët dhe aktivitetet që tregojnë ndryshimin e dinamikave të fuqisë në lidhje me kujtesën e konfliktit dhe marrëveshjen e paqes që i dha fund. Pjesa e parë e punimit trajton figurën e “mbrojtësve” dhe format mbizotëruese të përkujtimit të pjesëtarëve të rënë të forcave të sigurimit të shtetit, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, figurat e “fituesve” dhe “dëshmorëve”, që promovohen nga aktorë shqiptarë të politikës së kujtesës. Në pjesën e dytë të punimit, objekt i analizës janë modelet e ndërveprimit ndërmjet dy bashkësive etnike në kontekstin e kujtimit të konfliktit të armatosur të vitit 2001. Katër modelet e ndërveprimit që identifikon ky punim ndryshojnë në aspektin e shpërndarjes gjeografike, theksit të vendosur në episode të ndryshme nga viti 2001 dhe menaxhimit të kujtesës nga aktorët politikë.

1. Hyrje

Në gusht të vitit 2022 u bënë 21 vjet nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila i dha fund konfliktit tetë mujor të armatosur në Maqedoni dhe çoi në një riorganizim të rëndësishëm të qeverisë në shtetin e pasluftës. Armiqësitë filluan në janar të vitit 2001, kur një grup militant i rebelëve shqiptarë vendas, i vetëshpallur Armata Kombëtare Shqiptare (AKSH), sulmoi një stacion policor pranë Tetovës. Konfliktet u përshkallëzuan në mars dhe maj të të njëjtit vit. Muaj të konfliktit kanë lënë pas më shumë se 200 viktime, si dhe më shumë se 100 000 persona të zhvendosur brenda vendit.

Ky punim paraqet një analizë të përkujtimeve të konfliktit të armatosur në Maqedoninë e Veriut nga përfundimi zyrtar i tij në gusht të vitit 2001 e deri më sot. Analiza tregon se ekzistojnë dy mënyra dominuese të përkujtimit të vitit 2001 në Maqedoninë e pasluftës, që përkohjnë me dy bashkësitë më të mëdha etnike në shtet, maqedonase dhe shqiptare.¹ Pjesa e parë e punimit trajton figurën e "mbrojtësve" dhe format mbizotëruese të përkujtimit të pjesëtarëve të rënë të Forcave të Armatosura të shtetit, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, figurat e "fituesve" dhe "dëshmorëve", promovuar nga aktorë shqiptarë të politikës së kujtesës. Në pjesën e dytë të punimit, objekt i analizës janë modelet e ndërveprimit ndërmjet dy bashkësive etnike në kontekstin e kujtimit të konfliktit të armatosur të vitit 2001. Katër modelet e identifikuara të ndërveprimit ndryshojnë në aspektin e shpërndarjes gjeografike, theksimit në episode të ndryshme nga viti 2001 dhe "menaxhimit" të kujtesës nga institucionet shtetërore dhe aktorët e shoqërisë civile.²

Analiza e paraqitur në këtë punim bazohet në studimet e nacionalizmit dhe kujtesës dhe gjasjet e tyre ndaj praktikave të përditshme në kontekstet pas konfliktit.³ Qëllimi i analizës është të hartojë prodhimin e diskurseve, narrativave dhe praktikave rreth konfliktit të vitit

1 Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë nga viti 2022, maqedonasit etnikë përbëjnë 58,4 dhe shqiptarët etnikë 24,3 për qind të popullsisë së përgjithshme të Maqedonisë së Veriut.

2 Në punim, procesi i menaxhimit ose "administrimit" të kujtesës kuptohet në përputhje me: Sara Dybris McQuaid and Sarah Gensburger, "Administrations of Memory: Transcending the Nation and Bringing Back the State in Memory Studies," *International Journal of Politics, Culture, and Society* 32, no. 2 (2019): 125-143.

3 Për vështrim, të shihet: Denisa Kostovicova, Ivor Sokolić, and Orli Fridman, "Below Peace Agreements: Everyday Nationalism or Everyday Peace?" *Nations and Nationalism* 26, no. 2 (2020): 424-430.

2001 nga një këndvështrim afatgjatë. Rolin kryesor në këto procese gjatë dy dekadave të fundit e kanë pasur elitat politike, por ka edhe shembuj ku tendencat dhe ndryshimet kryesore në këtë periudhë janë bazuar në interpretimet e konfliktit të armatosur që vijnë nga poshtë. Proceset e menaxhimit të kujtesës së vitit 2001 janë të ndryshme dhe të përcaktuara nga historitë lokale të marrëdhënieve ndëretnike, ngjarjet individuale gjatë konfliktit të armatosur tetë mujor dhe debatet komunale pas vitit 2001.

Punimi harton të gjitha këto dinamika përmes analizës së "industrisë së kujtesës" si fushë përkujtimore, prodhimi kulturor dhe pasqyrimi mediatik për konfliktin.⁴ Përveç kësaj, objekt analize janë edhe hapësirat e kujtesës si vende kritike të paraqitjeve fizike dhe vizuale të së kaluarës në publik.⁵ Kujtimet individuale të konfliktit të armatosur në Maqedoni në vitin 2001 nuk janë objekt analize, edhe pse punimi prek disa kujtime dhe histori gojore kur flet për disa modele kolektive të kujtesës. Në mënyrë të ngjashme, në punim shmangen përfundimet normative dhe autori nuk mbron asnjë model të kujtesës. Në vend të kësaj, theksi vihet në dëshmitë empirike nga dy dekadat e mëparshme dhe synimi është të identifikohen dhe analizohen aktorët kryesorë, veprimet dhe aktivitetet në fushën e memorializimit në atë periudhë.

4 Për industrinë e kujtesës, të shihet: Jelena Đureinović, *Politika sećanja na ratove devedesetih u Srbiji: Istorijski revizionizam i izazovi memorijalizacije* (Beograd: Fond za humanitarno pravo, 2021).

5 Për hapësirat e kujtesës (memoryscapes), të shihet: Vjeran Pavlaković: *Memoryscapes of the Homeland War* (Rijeka: University of Rijeka, 2022).

2. Konflikti i armatosur në vitin 2001

2.1. Maqedonia në Jugosllavi: Parahistoria

Përshkallëzimi i tensioneve ndëretnike në një konflikt të armatosur në vitin 2001 ka një histori disa dekadash në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal.⁶ Përpjekjet e para për të institucionalizuar një popullsi multietnike si dhe për marrëdhëniet ndëretnike në historinë moderne erdhën me Luftën Nacionalçlirimtare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lufta antifashiste i hapi rrugën themelimit të shtetit maqedonas në kuadër të Jugosllavisë dhe me këtë përfundoi programin e ndërtimit të kombit dhe shtetit. Deklarata e ASNOM-it për të drejtat themelore të qytetarëve nga viti 1944 dhe Kushtetuta e Republikës Popullore të Maqedonisë e miratuar dy vjet më vonë, për herë të parë zyrtarizuan gjuhën, identitetin dhe kulturën e maqedonasve dhe të pakicave etnike. Të drejtat e pakicave u zgjeruan më tej nga kushtetuta jugosllave e vitit 1963 dhe ardhja në pushtet e një grupi liberal politikanësh në Maqedoni gjatë viteve të gjashtëdhjeta.⁷ Deri në fund të viteve të gjashtëdhjeta, numri i përfaqësuesve politikë të grupeve minoritare u rrit si dhe prania e tyre në shkolla dhe universitete, dhe disa komuna maqedonase zyrtarizuan përdorimin e gjuhëve dhe flamujve të grupeve minoritare.⁸

Fillimi i viteve të shtatëdhjeta në Maqedoni u karakterizua me ardhjen në pushtet të

6 Vasiliki Neofotistos thotë se ky ishte rezultat i një "fluksi" në marrëveshjet sociopolitike dhe ndryshimet e tyre në Maqedoni dhe jashtë saj: *The Risk of War: Everyday Sociality in the Republic of Macedonia* (Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 2012), 5-6.

7 Për konceptin e liberalit në Maqedoninë socialiste, të shihet: Neven Radičeski, *Liberalizmot vo Makedonija (1966-1974)* (Skopje: Makedonika Litera, 2013).

8 Dušan Anakioski, "Kretanje zaposlenosti i promene u socijalnoj strukturi stanovništva SR Makedonije," *Stanovništvo* 5-4 (1967): 293-304; Ranka Čičak, "Podelja vlasti u Sobranju," *Vjesnik*, 22.12.1969.

një rryme më konservatore, si dhe me një rritje të papunësisë. Vdekja e Josip Broz Titos, protestat e shqiptarëve në Kosovë dhe në disa qytete maqedonase dhe rezultatet e regjistrimit të popullsisë në fillim të viteve të tetëdhjeta shkaktuan ndryshime të mëdha në politikën maqedonase që ndikuan në marrëdhëniet ndëretnike në vitet në vijim.⁹ Elitat politike e panë ngritjen e nacionalizmit shqiptar si një sfidë kyçe për sigurinë kombëtare dhe nisën një fushatë kundër tij, duke e paraqitur atë si një domosdoshmëri për eliminimin e të gjitha nacionalizmave. Protestat e shqiptarëve etnikë, bojkoti i tyre ndaj institucioneve shtetërore, si dhe lidhjet me emigracionin politik shqiptar, nxitën më tej fushatën shtetërore, e cila u përhap në sfera të ndryshme të shoqërisë.¹⁰ Këto politika shtetërore çuan në marginalizimin e popullsisë shqiptare dhe zhvillimin e dy rrethave të veçanta politike në shtet.¹¹ Përjashtimi nga sektori shtetëror dhe mbrojtja sociale i detyroi shqiptarët e Maqedonisë që të emigronin brenda dhe jashtë Jugosllavisë dhe në tregti në shkallë të vogël. Para shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste, dy bashkësitë më të mëdha etnike në Maqedoni kishin perceptime shumë të ndryshme për mënyrën se si do të shembet shteti maqedonas dhe kush do të paguajë çmimin për rënien e tij.¹²

2.2. Fundi i viteve të tetëdhjeta dhe fillimi i viteve të nëntëdhjeta

Në nëntor të vitit 1989, partia në pushtet në Maqedoni shtyu reforma të ngjashme me Glasnostin në Bashkimin Sovjetik: pluralizmin politik, zgjedhjet demokratike në dhjetor 1990 dhe një referendum të suksesshëm të pavarësisë në shtator 1991. Megjithëse politikanët shqiptarë bojkotuan referendumin e pavarësisë dhe regjistrimin e parë të

- 9 Të shihet: Irena Stawowy-Kawka, *Albańczyacy w Macedonii 1944-2001* (Kraków: Wydawnictwo UJ, 2014); i Marijana Stamova, *Albancite vo SR Makedonija prez poslednoto desetiletie v Titova Jugoslavija (1981-1991)* (Kyustendil – Gabrovo: Ivan Sapundžev, 2017).
- 10 Për një pasqyrë të diskurseve zyrtare, të shihet: Slavko Milosavljevski and Mirče Tomovski, *Albancite vo Republika Makedonija (1945-1995): Legislativa, politička dokumentacija, statistika* (Skopje: Studentski zbor, 1997).
- 11 Ulf Brunnbauer, "Fertility, Families and Ethnic Conflict: Macedonians and Albanians in the Republic of Macedonia, 1944-2022," *Nationalities Papers* 32, no. 3 (2004): 565-598.
- 12 *Ahmeti's village: The political economy of interethnic relations in Macedonia* (Skopje – Berlin: European Stability Initiative, 2002), 1.

popullsisë pas-jugosllave, një koalicion multietnik u formua me sukses në 1992.¹³ Për shkak të gjithë kësaj, para vitit 2001 ishte i përhapur besimi se kishte një relaksim të marrëdhënieve ndëretnike përmes demokratizimit politik, përvojës së përfaqësimit politik gjithëpërfshirës dhe hapjes së Maqedonisë ndaj bashkësisë ndërkombëtare, pavarësisht tensioneve në rajon.¹⁴ Megjithatë, politikat dhe trashëgimitë e viteve të tetëdhjeta rezultuan të mos ishin aq të largëta sa mendohej fillimisht, megjithëse zyrtarët qeveritarë bënë përpjekje për të avancuar të drejtat e pakicave në fillim të viteve të nëntëdhjeta.¹⁵

Vitet e nëntëdhjeta në Maqedoni u shënuan nga privatizimi problematik, reformat e ngadalta dhe mungesa e investimeve të huaja. Për më tepër, kishte mosmarrëveshje të shumta me vendet fqinje: me Greqinë për emrin e shtetit, me Bullgarinë për gjuhën dhe historinë maqedonase, me Serbinë për statusin e Kishës Ortodokse Maqedonase dhe, deri në vitin 1998, me Shqipërinë për të drejtat e Shqiptarët etnikë në Maqedoni. E gjithë kjo çoi në kolapsin e mekanizmave demokratikë të menaxhimit të marrëdhënieve ndëretnike në "parapolitikë" gjatë viteve të nëntëdhjeta dhe mutacionin e tyre në një konkurrencë të vazhdueshme midis dy grupeve etnike për kulturën, politikën dhe identitetin.¹⁶ Tensionet përgjatë vijave etnike u rishfaqën në fillim të viteve të nëntëdhjeta. Në disa raste, tensionet u përshkallëzuan në dhunë. Katër persona humbën jetën në përleshjet mes policisë dhe kontrabandistëve të cigareve me kombësi shqiptare në vitin 1992, ndërsa në nëntor të vitit pasardhës u arrestuan disa shqiptarë për tregti të paligjshme armësh dhe synim për të krijuar organizata paraushtarake.¹⁷

Tensionet më të mëdha përgjatë vijave etnike gjatë viteve të nëntëdhjeta u zhvilluan në komunat me shumicë shqiptare, "zona të ndërveprimit" ndërmjet dy bashkësive

13 Ishte i vetmi kabinet multietnik në Evropën post-socialiste deri në vitin 1992. Gale Stokes, *The Walls Came Tumbling Down: The Collapse of Communism in Eastern Europe* (Oxford – New York: Oxford University Press, 1993), 252; Kronologjia e shkurtër e viteve të hershme të Maqedonisë post-socialiste mund të gjendet në: Mišo Dokmanovikj, *Sami na svoeto: Kratka istorija na makedonskata nezavisnost (1990-1993)* (Skopje: FES, 2021).

14 Të shihet: John Marks and Eran Fraenkel, "Working to Prevent Conflict in the New Nation of Macedonia," *Negotiation Journal* 13, no. 3 (1997): 243-252; Vladimir T. Ortakovski, "Interethnic Relations and Minorities in the Republic of Macedonia," *Southeast European Politics* 2, no. 1 (2001): 24-45.

15 Në vitin 1992, autoritetet ishin afër arritjes së një marrëveshjeje që do të përmirësonte të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, dispozitat e së cilës më vonë u përkthyen në MKO, sipas diplomatit të OSBE-së Gert Heinrich Arens, i cili ishte i përfshirë në negociatën. Mančo Mitevski, 2001: *Vajna so dve lica* (Skopje: Kultura, 2008), 64-65.

16 Keith S. Brown, "In the realm of the double-headed eagle: Parapolitics in Macedonia 1994-9", in *Macedonia: The Politics of Identity and Difference*, ed. J.K. Cowan (London: Pluto Press, 2000), 122-139.

17 Brown, "In the realm...", 128.

etnike, siç janë Tetova apo Gostivari. Një nga incidentet më të mëdha ka ndodhur në Gostivar në vitin 1997 pas vendosjes së flamurit shqiptar para ndërtesës së komunës. Heqja e flamurit nga policia shkaktoi demonstrata lokale që u shtypën brutalisht, duke rezultuar në tre të vdekur dhe më shumë se 200 protestues të plagosur.¹⁸ Krahu i djathtë i opozitës maqedonase instrumentalizoi protestat shqiptare për ringjalljen e nacionalizmit maqedonas, i cili përfundimisht hapi dyert për një fitore zgjedhore për VMRO-DPMNE-në në vitin 1998.¹⁹ Pas zgjedhjeve, VMRO-DPMNE arriti të formojë qeverinë përmes koalicionit me Alternativat Demokratike (AD) dhe Partinë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH).

2.3. Armiqësitë e armatosura

Konflikti i armatosur në Maqedoni filloi më 22 janar 2001 me një sulm gueril në stacionin policor në fshatin Tearcë afër Tetovës dhe një sulm në një tren pasagjerësh në Maqedoninë perëndimore disa ditë më vonë më 26 janar. Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK) e vetëshpallur, një grup me të njëjtin akronim shqip si Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), mori menjëherë përgjegjësinë për të dy sulmet.²⁰ Këto ngjarje befasuan shoqërinë maqedonase dhe elitat politike, si dhe analistët dhe diplomatët.²¹ Dy parti politike parlamentare të shqiptarëve të Maqedonisë dënuan veprimtarinë e UÇK-së.

Incidentet ndodhën menjëherë pas shënimit të kufijve dhe marrëveshjeve ndërmjet Maqedonisë dhe Serbisë në fillim të vitit 2001, të cilat u gjykuan nga politikanët dhe zyrtarët e Kosovës, dhe pas ndërprerjes së armiqësive në rajonin e Preshevës në Serbinë

18 Brown, "In the realm...", 129-133.

19 VMRO-DPMNE është shkurtesë e Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia për Bashkim Kombëtar Maqedonas (në maqedonisht: *Vnatrešna makedonska revolucionarna organizacija-Demokratska partija za makedonsko nacionalno edinstvo*). Partia dhe lideri i saj, Lubčo Georgievski, përdorën një platformë antishqiptare për të fituar mbështetje dhe fushatën elektorale në vitet 90-ta. Në vitin 1997, ata mbështetën protestat studentore të maqedonasve etnikë kundër arsimit universitar në gjuhën shqipe dhe universitetit shqiptar të hapur ilegalisht në Tetovë.

20 Për formimin e UÇK-së (Ushtria Çlirimtare Kombëtare), të shihet: Mair Iseni, Petrit Menaj, and Rufi Osmani, *Izbor tekstovi za konfliktot od 2001 godina* (Skopje: FIOOM, 2008).

21 Zhidas Daskalovski, "The Independence of Kosovo and the Consolidation of Macedonia – A Reason to Worry?" *Journal of Contemporary European Studies* 16, no. 2 (2008), 276.

jugore në nëntor të vitit 2000.²² Vetëm pak muaj para këtyre ngjarjeve, në vitin 1999, Forcat e Shpërndara Parandaluese të OKB-së, UNPREDEP, përfunduan mandatin e tyre katërvjeçar të monitorimit të zonave kufitare në Maqedoni.²³ Tërheqja e tyre mundësoi kalime të paligjshme në kufijtë e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë.²⁴

Njohuritë për kalimin e kufijve nga luftëtarët nuk e pengoi shpërthimin e armiqësive në Maqedoni. Pas sulmeve të para, forcat e sigurimit shtetëror maqedonas i shtypën rebelët përtej kufirit shtetëror verior.²⁵ Megjithatë, konfliktet shpërthyen përsëri në mars të vitit 2001 dhe u përhapën në Tetovë, ku UÇK zuri pozicionet në kalanë e Kalesë dhe rrethoi qytetin. Pas gati një jave të shtënave në një nga qytetet më të populluara në Maqedoni, autoritetet shtetërore i dhanë ultimatum UÇK-së dhe filluan të bombardojnë fshatrat afër Tetovës. Pas vetëm katër ditësh, forcat shtetërore njoftuan se operacioni ishte i suksesshëm.²⁶ Megjithatë, më 28 prill, UÇK-ja i zuri pritë një autokolone të forcave të armatosura shtetërore në fshatin Vejce, afër Tetovës, ku u vranë tetë pjesëtarë të forcave shtetërore dhe gjashtë u plagosën. Prita shkaktoi incidente në disa qytete maqedonase, duke përfshirë shkatërrimin e pronave në pronësi të shqiptarëve etnikë, veçanërisht në Manastir, vendlindjen e katër anëtarëve të rënë të forcave të armatosura shtetërore.

Në maj të vitit 2001, armiqësitë u zhvendosën në zonat verilindore rreth Kumanovës ku UÇK-ja vendosi kontrollin mbi disa fshatra. Ushtria e Republikës së Maqedonisë (URM) përsëri përdori taktikën e granatimeve të fshatrave duke përdorur zjarr të rëndë artilerie dhe tankesh, të mbështetur nga helikopterët që gjuanin raketa, siç e përshkruan gazetari John Phillips i cili raportoi nga "territoret e çliruara" të kontrolluara nga UÇK-ja në zonën e Kumanovës.²⁷ Në këtë territor, luftimet zgjatën shumë më gjatë se në Tetovë për disa arsye: mobilizimi i suksesshëm i shqiptarëve vendas nga UÇK-ja, civilët e shumtë që refuzuan

22 Pavlos I. Koktsidis, "The Decision to Use Violence: Opportunity Structures and the Albanian Insurgency in the Former Yugoslav Republic of Macedonia," *Ethnopolitics* 18, no. 4 (2019): 383-405.

23 Fundi i mandatit të UNPREDEP erdhi pasi Kina vuri veton për veprimin e tij pasi Maqedonia njohu Tajvanin. Për misionin e UNPREDEP-it në Maqedoni, të shihet: Henryk J. Sokalski, *Odrobina prewencji: Dorobek dyplomacji prewencyjnej ONZ w Macedonii* (Warszawa: Instytut Spraw Międzynarodowych, 2007), 141-312.

24 Të shihen, për shembull, kujtimet e presidentit të parë të Republikës së Maqedonisë, Kiro Gligorov: Kiro Gligorov, *Makedonija e sé što imame* (Skopje: Kultura, 2002), 588-599.

25 Zidas Daskalovski, "The Macedonian Conflict of 2001: Between Successful Diplomacy, Rhetoric and Terror," *Studies in Post-Communist*, Occasional Paper no. 7 (2004): 7-11.

26 *Conflicting Perceptions: A study of prevailing interpretations of the conflict in Macedonia among Albanian and Macedonian communities* (The Norwegian Helsinki Committee Report, 2003).

27 John Phillips, *Macedonia: Warlords and Rebels in the Balkans* (London – New York: I.B.Tauris, 2004), 105.

mundësinë për t'u zhvendosur në një vend të sigurt nga humanitarët ndërkombëtarë (siç shpjegon Phillips, autoritetet shtetërore pretenduan se UÇK-ja përdorte civilët si pengje dhe mburoja njerëzore), si dhe për shkak të pozicionit strategjik të fshatit Likovë pranë dy rezervuarëve që siguronin ujë për Kumanovën, të cilat UÇK-ja i përdori si mjet në luftime.²⁸

Edhe pse forcat shtetërore arritën të rimarrin kontrollin e fshatit Vaksincë në fund të majit dhe ndërprejnë korridorin Tetovë-Kumanovë, perceptimi i përhapur në mesin e vëzhguesve të huaj ishte se shtetit i mungonte kapaciteti ushtarak për t'u marrë me kryengritësit.²⁹ Kjo doli si e vërtetë në fund të qershorit, kur UÇK-ja konsolidoi pozicionet në fshatin Haraçinë, afër Shkupit dhe aeroportit ndërkombëtar, dhe kërcënoi të sulmonte kryeqytetin dhe të bombardonte rafinerinë e naftës aty pranë. Kjo manovër e UÇK-së alarmoi komunitetin ndërkombëtar dhe i shtyu të dyja palët drejt armëpushimit. Pas disa ditësh, qeveria maqedonase filloi një ofensivë ushtarake në Haraçinë, e cila nuk solli rezultat edhe pas pesë ditësh të shtënave.³⁰ Komuniteti ndërkombëtar, nëpërmjet të dërguarit të BE-së, Javier Solana, ndërhyri me qëllim të arritjes së armëpushimit dhe autoritetet maqedonase ranë dakord për t'i dhënë fund ofensivës dhe për të tërhequr forcat e tyre të armatosura. Më 25 qershor, ushtarët e NATO-s të Forcave të Kosovës (KFOR) ndihmuan në evakuimin e luftëtarëve të UÇK-së në territoret e kontrolluara nga rebelët.³¹

Situata gjatë muajit qershor ishte padyshim ndryshe nga ajo e fazave të mëparshme të konfliktit të armatosur. Nga mesi i majit u formua qeveria e unitetit kombëtar që mbledhi të gjitha partitë parlamentare, ndërsa UÇK-ja filloi të koordinonte objektivat e saja me dy partitë më të mëdha shqiptare në Maqedoni. UÇK-ja ndaloj ofendimin e maqedonasve etnikë në deklaratat e saj, e artikuloj luftën e saj si luftë për të drejtat e njeriut dhe kundër ndarjes territoriale të shtetit maqedonas dhe më në fund fitoj legjitimitet politik përmes partive politike shqiptare që fillimisht hodhën poshtë metodat e UÇK-së.³² Megjithatë, megjithë gatishmërinë e dukshme më të madhe për bashkëpunim politik dhe negociata

28 Phillips, *Macedonia*, 103-116.

29 Phillips, *Macedonia*, 103.

30 Daskalovski, "The Macedonian Conflict of 2001", 9.

31 Saso Ordanoski, "Lions & Tigers: The Militarisation of the Macedonian Right," in *Conflict in FYROM – Reflection*, ed. J. Pettifer (London: Institute of War & Peace Reporting, 2004), 17-28.

32 Iso Rusi, "From Army to Party – The Politics of the NLA," in *Conflict in FYROM – Reflection*, ed. J. Pettifer (London: Institute of War & Peace Reporting, 2004), 1-16.

paqeje që çuan në një armëpushim në fillim të korrikut, UÇK-ja vazhdoi të sulmojë forcat shtetërore dhe të rrëmbejë civilë.

Armiqësitë vazhduan në gusht të vitit 2001 në të njëjtën kohë me përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për të arritur një armëpushim të përhershëm. Më 8 gusht, UÇK-ja ndërpreu kolonën e forcave shtetërore pranë Karpalakut dhe vrau dhjetë dhe plagosi tre anëtarë të kolonës. Kjo ngjarje i përshpejtoi negociatat dhe vendi ku u bë prita u bë një nga vendet më të rëndësishme të kujtesës kur bëhet fjalë për konfliktin e armatosur të vitit 2001. Menjëherë pas kësaj, më 13 gusht, presidenti maqedonas dhe liderët e katër partive më të mëdha politike, dy maqedonase dhe dy shqiptare, nënshkruan një marrëveshje paqeje të quajtur Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO). Muaj të konfliktit në 2001 çuan në më shumë se 200 viktima dhe më shumë se 170 mijë persona të zhvendosur brenda vendit.³³ Kulmi u arrit në gusht dhe shtator, kur 70 000 njerëz u regjistruan si të zhvendosur brenda vendit ose refugjatë, 60 për qind e të cilëve ishin maqedonas etnikë.³⁴ Pothuajse 95 për qind e personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatëve u kthyen në shtëpitë e tyre deri në vitin 2003.³⁵ Numri i pjesëtarëve të vrarë të rebelëve dhe forcave shtetërore si dhe viktimitave civile ndryshon në varësi të këndvështrimit etnik për konfliktin dhe mediat maqedonase shpesh promovojnë imazhe të tilla të konfliktit.

2.4. Marrëveshja Kornizë e Ohrit

Nënshkrimi i MKO u bë pas disa ditësh negociata të organizuara nga përfaqësuesit e BE-së dhe SHBA-së në Villa Bilana në Ohër, ish-rezidenca verore e Titos dhe rezidenca e sotme e Presidentit të Republikës së Maqedonisë. Marrëveshja është lidhur më 13 gusht 2001 me nënshkrimet e presidentit maqedonas, liderëve të dy partive më të mëdha maqedonase

33 Për numrin e viktimitave të shihet: Ulf Brunnbauer, "The Implementation of the Ohrid Agreement: Ethnic Macedonian Resentments," *Journal on ethnopolitics and minority issues in Europe* 1, no. 1 (2002): 1-23. Debatë, ndër të tjera, edhe për numrin e viktimitave mund të gjendet edhe në botimin e mëposhtëm: *Istorijska i apokrifna demitologizacija na 2001: Debata* (Skopje: FOOM, 2010).

34 *Profile of internal Displacement: Macedonia* (Geneva: Norwegian Refugee Council – Global IDP Project, 2002). Të shihet edhe raporti vjetor për shkeljet e të drejtave të njeriut në Maqedoni në vitin 2001 nga Federata Ndërkombëtare e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

35 *Konečnen izveštaj: Procenka na reintegracijata na raselenite lica i revitalizacija na regionite pogodeni od konfliktot vo Makedonija* (Skopje: MCMS – FAKT, 2003).

dhe dy partive më të mëdha politike shqiptare në vend, si dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare.³⁶ Versioni i publikuar i MKO nuk përfaqëson vetëm armëpushimin e zakonshëm, por gjithashtu përfshin synimin për të ripërcaktuar rregullimin institucional të të drejtave të pakicave dhe marrëdhënieve ndëretnike në shtet. MKO përfshin tri tema kryesore: amendamentet e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ndryshimet legislative dhe planin për ndërprerjen gradual të armiqësive dhe çarmatimin e UÇK-së.³⁷

Marrëveshja çoi në ripërcaktimin e Republikës së Maqedonisë si shtet i të gjithë qytetarëve të saj, futi gjuhët e pakicave si gjuhë zyrtare në komunat me më shumë se njëzet për qind të popullsisë që i flet ato gjuhë dhe vendosi një ndarje të butë të pushtetit.³⁸ Ky mekanizëm bazohet në pjesëmarrjen më të madhe të grupeve minoritare në institucionet publike dhe në parimin e votimit të dyfishtë etnik për të gjitha ligjet që prekin kulturën, përdorimin e gjuhës, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve.³⁹ Në parim, MKO mundësoi uljen e pushtetit politik në nivel lokal dhe shërbeu si shtytësi kryesor për krijimin e autonomisë së bashkësive etnike.⁴⁰ Një kusht për ndryshimet ishte një operacion çarmatimi i UÇK-së i udhëhequr dhe i mbikëqyrur nga NATO, si dhe rivendosja e mëpashme e forcave të sigurisë shtetërore në zonat e kontrolluara nga rebelët.

Një nga çështjet më të diskutueshme që lind nga MKO është zbatimi i Ligjit për Organizimin e Territorit nga viti 2004, i cili e zvogëloi numrin e komunave nga 123 në 84 dhe në këtë mënyrë maksimizoi mundësinë e një strukture të popullsisë komunale ku qytetarët me kombësi shqiptare përbëjnë më shumë se njëzet për qind.⁴¹ Kjo çështje shkaktoi tensione dhe përfundimisht çoi në një referendum kundër përcaktimit të kufijve të rinj komunalë, i cili përfundoi me një pjesëmarrje të ulët prej 26 për qind të qytetarëve, që është e pamjaftueshme për formimin e një procesi legjislativ.

36 Për negociatat që çuan në nënshkrimin e MKO: Veton Ljati, *Pregovorite za postignuvanje na Ohridskiot dogovor* (Skopje: FOOM, 2008).

37 *Marrëveshja kornizë*. Marrëveshja kuadër. Lidhur në Ohër dhe nënshkruar në Shkup, Maqedoni më 13 gusht të vitit 2001.

38 Florian Bieber, "Power-Sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement," in *Power-Sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement* (Skopje: FES, 2008), 7-40.

39 Të shihet: Aisling Lyon, "Political decentralization and the strengthening of consensual, participatory local democracy in the Republic of Macedonia." *Democratization* 22, no. 1 (2015): 157-178.

40 Risto Karajakov, "Macedonia's 2001 ethnic war: Offsetting conflict. What could have been done but was not?" *Conflict, Security & Development* 8, no. 4 (2008): 451-490.

41 Më shumë për këtë në: Eben Friedman, "The Ethnopolitics of Territorial Division in the Republic of Macedonia," *Ethnopolitics* 8, no. 2 (2009): 209-221.

Marrëveshja e Ohrit nuk parashikonte asnjë mekanizëm të drejtësisë tranzicionale, përveç të ashtuquajturit "Ligji për amnisti" i vitit 2002, i cili i përjashtoi të gjithë luftëtarët nga ndjekja penale, përveç atyre të përfshirë në krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe shkelje të tjera nën juridiksionin e GJNPJ.⁴² Në fillim të tetorit 2002, GJNPJ i kërkoi Maqedonisë të dërgojë pesë hetime për krimet e kryera nga UÇK-ja (4) dhe forcat e sigurisë shtetërore (1). Autoritetet shtetërore pranuan kërkesën e gjykatës në fund të nëntorit 2000. Megjithatë, në prill 2005, GJNPJ njoftoi se e vetmja padi nga pesë rastet e pranuar do të ishte hetimi për vrasjet e dhjetë civilëve nga forcat e armatosura shtetërore në Luboten.⁴³

Megjithëse u vlerësua në mesin e viteve 2000 si një model i suksesshëm për zgjidhjen e çështjes së të drejtave të pakicave, MKO përfundimisht çoi në ndërtimin e një regjimi të veçantë civil në Maqedoninë e pasluftës që Lubica Spaskovska e quan "shtetësia etnike" (*ethnizenship*). Në këtë regjim qytetarët marrin pjesë në sferën publike ekskluzivisht si anëtarë të bashkësive etno-kombëtare ose fetare⁴⁴ Ndarjet përgjatë vijave etnike u krijuan më tej në shumë fusha sociale, politike dhe ekonomike. Praktikrat e koncesioneve politike, negociatat për financimin komunal dhe pritjet publike pas Marrëveshjes së Ohrit kontribuan në krijimin e një modeli pothuajse të padepërtueshëm të përjashtimit të grupeve të tjera etnike nga platformat e supozuara për bashkësitë etnike, fetare dhe gjuhësore. Një ilustrim i mirë i këtyre praktikave në sferën e kulturës është ekzistenca dhe mbajtja paralele e dy festivaleve të muzikës pop, Festivali i Shkupit dhe Nota Fest. Të dy festivalet mbahen në të njëjtin vend në Shkup, por pa pjesëmarrjen e këngëtarëve të kombësisë shqiptare në rastin e parë dhe pa këngëtarë maqedonas në rastin e festivalit të dytë.⁴⁵

Praktikat e ndryshme të përkujtimit kanë ndihmuar në ruajtjen e regjimit etnik të lartpërmendur të pjesëmarrjes në jetën publike, pasi aktivitetet përkujtimore në lidhje me

42 Elmina Kulasic, *Transitional Justice in Macedonia and its Relations with Democracy* (Skopje: KAS – CRPM, 2012).

43 Zoran Ilievski, *Ethnic Mobilization in Macedonia* (Bozen – Bolzano: European Academy, 2007), 25-26.

44 Ljubica Spaskovska, "The fractured 'we' and the ethno-national 'I': the Macedonian citizenship framework," *Citizenship Studies* 16, no. 3-4 (2012): 383-396.

45 Maja Muhic, Violeta Simjanovska, and Lea Linin, "Re-thinking cultural policy: From strategy to reality – intercultural dialogue and cultural diversity in Macedonia," in *Cultures and sustainable development at times of crisis* (Belgrade: University of Arts in Belgrade, 2014), 329-345.

konfliktin e armatosur të vitit 2001 zhvillohen kryesisht në domenet e dy komuniteteve etnike. Megjithatë, kur shikojmë zhvillimet ndër vite, shohim se praktikat përkujtimore brenda dy fushave etnike nuk janë aq uniforme sa mund të duken. Gjegjesisht, gjatë dy dekadave të fundit, ka pasur ndryshime kritike në diskurset, aktorët dhe aktivitetet përkujtimore që tregojnë se dinamika e pushtetit lidhur me kujtesën e konfliktit të armatosur dhe armëpushimit po ndryshon.

3. Dy kultura të kujtesës

3.1. Mbrojtësit

Që nga fillimi i armiqësive në janar 2001, forcat e armatosura shtetërore i janë paraqitur publikut maqedonas si mbrojtës. Figura e mbrojtësit përfshin forcat policore dhe ushtarake, si dhe forcat rezervë të mobilizuara nga URM gjatë konfliktit. Ideja e mbrojtësve nënkupton gjithashtu se këto formacione luftuan për të mbrojtur integritetin territorial dhe pavarësinë e Republikës së Maqedonisë. Edhe pse mbrojtësi nuk është një kategori ligjore, termi përshtatet me ligjin e vitit 2002 që rregullon të drejtat e pjesëtarëve të forcave shtetërore dhe familjeve të tyre. Ligji është ndryshuar disa herë gjatë viteve të dy mijëta dhe një kompromis përfundimtar që do të zgjidhte shumë pengesa administrative për kompensimin e atyre që konsiderohen si mbrojtës dhe familjeve të tyre duket ende i pakapshëm. Arsyeja kryesore për ngecjen në këtë çështje është Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), një parti politike e themeluar në vitin 2002 nga ish-luftëtarët e UÇK-së, e cila hedh poshtë hapur çdo zgjidhje legjislative që nuk u siguron ish anëtarëve të UÇK-së të njëjtat të drejta si forcave të armatosura të shtetit si dhe familjeve të tyre.

Mosmarrëveshjet mbi "ligjin e mbrojtësve" janë një shembull i luftës simbolike për konfliktin e armatosur dhe armëpushimin në diskutet publike në Maqedoninë e Veriut. Nga njëra anë, ish-pjesëtarët e forcave të armatosura shtetërore dhe publiku etnik maqedonas në përgjithësi e shohin realizimin e mundshëm të kërkesës së BDI-së për kompensim për luftëtarët e UÇK-së si shpërblim të terroristëve dhe ngritjen e tyre në nivelin ligjor të mbrojtësve të shtetit.⁴⁶ Nga ana tjetër, kërkesat e BDI-së për të njëjtat privilegje si forcat e armatosura burojnë nga kuptimi i tyre se UÇK ishte një palë legjitime në konfliktin që

46 Siç tha në 2012 kreu i Shoqatës së Mbrojtësve të Kumanovës, Predrag Petrushevski: Klauđija Lutovska, "Defenders' Law Shakes Macedonia Politics," *SETimes*, 16.09.2012. Në dispozicion në <https://www.eurasiareview.com/16092012-defenders-law-shakes-macedonia-politics/>

luftoi për avancimin e të drejtave të njeriut brenda institucioneve dhe kufijve shtetërorë. Vitet e fundit, ngjarjet përkujtimore të organizuara nga BDI dhe aktorë pranë saj janë bërë platforma për promovimin e këtij pozicioni.

Në këtë kontekst të debateve të mprehta publike për konfliktin e armatosur, institucionet shtetërore filluan të zhvillojnë aktivitete përkujtimore kushtuar pjesëtarëve të forcave të armatosura maqedonase të vrarë në vitin 2001. Është e rëndësishme të theksohet se këto aktivitete filluan menjëherë pas përfundimit të armiqësive të armatosura që në vitin 2002, për shembull, vetëm disa muaj pas nënshkrimit të MKO, Ministria e Punëve të Brendshme vendosi një pllakë përkujtimore kushtuar policëve të vrarë si dhe një flakë të përjetshme para selisë së saj në Shkup. Ky vend u bë vend qendror për festimin e 7 majit, Ditës së Policisë së Maqedonisë.⁴⁷ Në mënyrë të ngjashme, Ministria e Mbrojtjes dhe URM kanë vendosur përkujtimore të ndryshme kushtuar pjesëtarëve të tyre të vdekur në konflikt në lokacione brenda komplekseve të tyre institucionale.

Që nga viti 2002, autoritetet lokale dhe organizatat e veteranëve kanë iniciuar pllaka përkujtimore kushtuar pjesëtarëve të rënë të forcave të armatosura në hapësirat publike. Një nga pllakat e para u vendos në komunën e Draçevës në Shkup, ndërsa nga mesi i viteve 2000 objekte të ngjashme u vendosën edhe në qytete të tjera të Maqedonisë, si Strumicë dhe Berovë. Pllakat përkujtimore përkujtojnë pjesëtarët e rënë të forcave ushtarake me theks të veçantë tek ata që kanë lindur në atë komunë dhe i paraqesin si patriotë dhe heronj kombëtarë. Si dhe institucionet shtetërore, komunitetet dhe organizatat lokale organizojnë gjithashtu praktika të ndryshme përkujtimore në vendet e monumenteve dhe objekteve të tjera përkujtimore që lidhen me konfliktin e armatosur të vitit 2001. Në shumë vende dhe qytete me shumicë maqedonase, të cilat nuk janë prekur drejtpërdrejt nga konflikti, ditë të ndryshme komunale shpesh përfshijnë aktivitete përkujtimore lidhur me konfliktin.

Rëndësia e përkujtimeve të banorëve vendas për komunitetet është gjithashtu e dukshme në llojet e tjera të praktikave përkujtimore, të tilla si turne sportive përkujtimore, dhënia vullnetare e gjakut dhe ndryshimi i emrave të rrugëve dhe shkollave. Në këto ngjarje marrin pjesë jo vetëm vendasit, por edhe partitë politike, organizatat e shoqërisë civile dhe

47 "Sveceno odbelezan 7 maj, Denot na policijata," *Vreme*, 08.05.2004.

Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM). Kisha mori një rol të rëndësishëm në përkujtimet e forcave shtetërore, anëtarët e të cilave ishin kryesisht, por jo ekskluzivisht, të krishterë ortodoksë. Përfaqësuesit e kishës janë bërë pjesë e përkujtimeve zyrtare dhe nga poshtë që nga përfundimi i konfliktit të armatosur. Një nga përkujtimet e para të pjesëtarëve të rënë të forcave të armatosura ishte një ceremoni fetare e mbajtur në vitin 2002 në manastirin e Leshkokut, jo larg Tetovës, i cili u shkatërrua nga UÇK-ja në vitin 2001 dhe që u rindërtua menjëherë pas përfundimit të konfliktit.⁴⁸

Ngjarjet në komunën e Prilepit, vendlindjen e shumicës së pjesëtarëve të forcave të armatosura shtetërore në pritën në Karpalak, ilustrojnë marrëdhënien ndërmjet praktikave zyrtare të kujtimit dhe atyre që vijnë nga poshtë. Përkujtimet e para në Prilep filluan në fund të vitit 2001, kur trupat maqedonase u kthyen nga shërbimi dhe filluan të vizitojnë varret e bashkëluftëtarëve të rënë në vendlindjet e tyre. Në këto tubime morën pjesë edhe miqtë dhe familjet e ushtarëve të rënë maqedonas, të cilat përfundimisht u shndërruan në platforma për diskutime për mënyrat më të organizuara të ruajtjes së kujtimit të luftëtarëve të rënë. Në këtë mënyrë u formua shoqata e parë e veteranëve në Prilep, e cila në vitet në vijim u bë më aktive në organizimin e përkujtimeve vjetore në Karpalak, për të cilat do të flasim më gjerësisht në tekst. Shoqata gjithashtu u bë aktive në mbrojtjen e të drejtave të luftëtarëve dhe familjeve të pjesëtarëve të rënë të forcave të armatosura.⁴⁹

Përfaqësues të autoriteteve shtetërore marrin pjesë në përkujtimin e të vrarëve të forcave të armatosura që vijnë nga poshtë, si dhe në shërbimet përkujtimore. Në rastin e Prilepit, ish kryebashkiaku Marjan Risteski nga VMRO-DPMNE, edhe vetë mbijetoi pritën në afërsi të Karpalakit. Gjatë mandatit të tij nga viti 2005 deri në vitin 2017, Risteski kujtimin e bashkëluftëtarëve të rënë e shndërroi në një projekt të madh kulturor në komunë. Përveç monumentit dhe dhomës përkujtimore brenda ndërtesës në pronësi të URM-së që u ngritën menjëherë pas përfundimit të konfliktit, kabineti i Risteskit vendosi një pllakë përkujtimore në qendër të qytetit në vitin 2007, ndryshoi emrat e 13 rrugëve në emra të të vrarëve në pritën në afërsi të Karpalakut, dhe ngriti një kompleks memorial me dy monumente kushtuar "mbrojtësve të Prilepit". Të dy monumentet në Prilep janë 15 metra të larta dhe qëndrojnë në mes të dy rrethrotullimeve qendrore të trafikut.

48 Dejan Nikolovski, "Panihida vo Lešok za masakriranite braniteli," *Dnevnik*, 30.04.2002.

49 Të shihen rrëfimet personale të veteranëve në: *Voeni prikazni na prilepskite veterani od 2001* (Prilep: Mirovna akcija, 2020), 49-50.

Dy monumentet në Prilep paraqesin gjithashtu shembuj atipikë të arkitekturës përkujtimore të pas vitit 2001 kushtuar mbrojtësve maqedonas. Monumentet janë të depersonalizuara, përfshijnë simbolikë ortodokse dhe nuk kanë asnjë referencë kombëtare apo etnike. Monumenti i parë, për shembull, përfaqësohet nga dhjetë shtylla betoni mbi shatërvanin që simbolizojnë dhjetë mbrojtësit e vrarë dhe që mbajnë një top pulsues që përfaqëson jetët e përjetshme të mbrojtësve maqedonas.⁵⁰ Monumenti i dytë u përfundua dhe u zbulua në gusht të vitit 2013 në ditën e pritës në afërsi të Karpalakut. Monumenti është një kullë spirale moderniste që përkujton jo vetëm pjesëtarët e rënë të forcave shtetërore pranë Karpalakut, por edhe inatin e të gjithë luftëtarëve të historisë maqedonase që kanë lindur në Prilep.⁵¹ Dy monumentet luajnë një rol të rëndësishëm në përkujtimet vjetore të luftëtarëve maqedonas të vrarë në Karpalak.

Në përkujtimet shtetërore të të rënëve të Forcave të Armatosura maqedonase ka shumë nuanca, por e përbashkëta është se ato mbahen brenda komplekseve institucionale, në vendlindjet e luftëtarëve të rënë dhe së fundi në vendet ku janë bërë pritrat. Pika kyçe e të gjitha këtyre aktivitetëve janë monumentet që u ngritën për nder të tyre pas vitit 2001. Monumentet përshkruajnë anëtarët e rënë të forcave të armatosura si patriotë maqedonas dhe heronj kombëtarë dhe kryesisht përfshijnë simbole ortodokse. Përkujtimet zyrtare synojnë të solidarizohen me familjet, të afërmit dhe bashkëluftëtarët e atyre që dhanë jetën për atdheun. Këto ngjarje shpeshherë paraqesin sakrificën e mbrojtësve në dritën e luftës për shtetësinë maqedonase nga shekulli XIX deri në ditët e sotme. Në kuadër të pengesave të përmendura më parë në lidhje me të drejtat e luftëtarëve, përkujtimet vjetore shërbejnë edhe si platforma për të demonstruar përkushtimin e institucioneve në kujtimin e pjesëtarëve të rënë të Forcave të Armatosura.

50 Monika Taleska, "Spomen-obeležje Karpalak vo Prilep," *Radio Slobodna Evropa*, 03.04.2011. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/3545325.html>

51 "Kamen-temelnik za nov spomenik vo čest na Prilepskite braniteli," *A1on*, 11.03.2013. Në dispozicion në: <https://a1on.mk/macedonia/kamen-temelnik-za-nov-spomenik-vo-cest/>

3.2. Fitimtarët dhe martirët

Aktivitetet përkujtimore në lidhje me UÇK-në sillen kryesisht rreth nocioneve të luftës, sakrificës dhe fitores së kryengritësve shqiptarë. Këto karakteristika janë të ngjashme me dinamikën e pasluftës të përkujtimit të luftëtarëve të rënë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Kosovë.⁵² Megjithatë, ka fraksione politike konfliktuale në Kosovë që konkurrojnë për të drejtën për t'u konsideruar si trashëgimtarë autentikë të Luftës Çlirimtare të Kosovës.⁵³ Në Maqedoninë e pasluftës janë dy aktorë të padiskutueshëm që paraqiten si trashëgimtarë të luftës së vitit 2001, përkatësisht partia politike BDI dhe shoqata e veteranëve UÇK. (*Shoqata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së*).

Menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur, BDI dhe shoqata e veteranëve UÇK organizuan një sërë ngjarjesh për të shënuar "çlirimin" e fshatrave dhe qyteteve ku UÇK kishte vendosur kontrollin ushtarak në vitin 2001.⁵⁴ Ngjarjet më të mëdha ishin në Shemshevë afër Tetovës dhe Sllupçan afër Kumanovës dhe u organizuan në përvjetorin e kryengritjes së armatosur në ato vende. Përkujtimi në Shemshevë në vitin 2002 duhej të ishte në Tetovë, por organizatorët ndryshuan vendndodhjen për të shmangur tensionet ndëretnike nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare.⁵⁵ Edhe pse organizatorët u përpoqën të zbusnin imazhin publik të përkujtimeve vjetore, toni ishte festiv dhe përkujtimet e pozicionuan UÇK-në si fituese të konfliktit të vitit 2001.

Veteranët e BDI-së dhe UÇK-së, përveç përkujtimit të fillimit të rebelimit, po punojnë edhe në arkivimin e luftës së armatosur dhe ruajtjen e kujtimit të rebelëve të rënë. Sipas disa burimeve, UÇK ka humbur nga 60 deri në 100 luftëtarë gjatë konfliktit.⁵⁶ Iniciativat e dokumentimit nuk kanë qenë gjithmonë në bashkëpunim me institucionet shtetërore, siç është, për shembull, Muzeu i Lirisë në komunën e Çairit në Shkup, i cili u hap nga

52 Valur Ingimundarson, "The Politics of Memory and the Reconstruction of Albanian National Identity in Postwar Kosovo," *History and Memory* 19, no. 1 (2007): 95-123.

53 Stephanie Schwandner-Sievers, "The bequest of *Ilegalja*: contested memories and moralities in contemporary Kosovo," *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* 41, no. 6 (2013): 953-970.

54 Vasiliki Neofotistos, "The Construction of Albanian Martyrdom in the Republic of Macedonia," *NCEEER Working Paper* (2012): 1-14.

55 CONNEKT Country Reports. *Meso-Level Dynamics: Commemorations of the 2001 Macedonian conflict in Tetovo, North Macedonia* (European Institute of the Mediterranean, në përgatitje).

56 Të shihet: Sasho Klekovski, "Braniteli, ONA i civilnive žrtvi," *Megjutoa*, 20.09.2012. Në dispozicion në: <https://www.megjutoa.mk/2012/09/brانيتeli-ona-i-tsvilinite-zhrtvi/>

përfaqësuesit e BDI-së në vitin 2008. Ekspozita origjinale përfshinte dy periudha kohore: ndërtimin e hershëm të kombit shqiptar dhe luftën e armatosur të UÇK-së në vitin 2001.⁵⁷ Deri në vitin 2011 muzeu ka punuar pa regjistrim zyrtar dhe ka probleme të ndryshme në funksionimin e përditshëm që atëherë.⁵⁸ BDI hapi edhe një muze tjetër në vitin 2012, Muzeun UÇK në Sllupçan, i cili ekspozon sende ushtarake dhe përkujton luftëtarët e rënë të UÇK-së, por gjithashtu u dha hapësirë viktimave civile të kombësisë shqiptare.⁵⁹

Përzierja e periudhave të ndryshme historike në një narrativë kombëtare nuk është risi në Maqedoni, as në Kosovë dhe Shqipëri. Pra, ka një numër të madh të rasteve ku luftimet e shqiptarëve gjatë viteve të nëntëdhjeta dhe të dymijëta janë të lidhura me idenë e panshqiptarizmit. Kompleksi memorial i quajtur “Memoriali i Luftës së Nënës Shqiptare” (*Nëna shqiptare*) u hap në vitin 2013 në Zajas, një nga bastionet politike të BDI-së në pjesën perëndimore të Maqedonisë së Veriut. Shembulli më i fundit është Muzeu Kombëtar i Pavarësisë në Vlorë, Shqipëri, në hapjen e të cilit mori pjesë kreu i BDI-së, Ali Ahmeti.⁶⁰ Përveç fokusit të përgjithshëm në luftën etnike për njohje, të drejta dhe shtetësi, narrativa bazohet në individë të veçantë si Adem Jashari, një nga themeluesit e UÇK-së.⁶¹ Në nëntor të vitit 2012, për shembull, një monument kushtuar Jasharit u ngrit në Radushë, Maqedonia e Veriut. Monumenti përfaqëson një figurë të artë të Jasharit duke qëndruar në një tank të URM-së sekuestruar nga UÇK-ja, edhe pse forcat e policisë serbe e vranë Jasharin në vitin 1998 dhe nuk ka asnjë dëshmi se ai ka qenë ndonjëherë aktiv në territorin maqedonas.⁶²

57 Oliver Stanoeski, *Tranziciona pravda vo Republika Makedonija. Izveštaj za 2010-2011 godina* (Skopje: Centar za istraživanje i kreiranje politiki, 2013), 36.

58 “Përurohet muzeu i UÇK-së në Sllupçan,” *Telegrafi*, 21.11.2012.

59 “Ahmeti me porosi nga Vlora: Shokët që ranë nëpër beteja, ëndërronin të vinin në sheshin e flamurit,” *Politiko*, 12.03.2022. Në dispozicion në: <https://politiko.mk/2022/03/12/ahmeti-me-porosi-nga-vlora-shoket-qe-rane-neper-beteja-enderronin-te-vinin-ne-sheshin-e-flamurit/>

60 “Ahmeti me porosi nga Vlora: Shokët që ranë nëpër beteja, ëndërronin të vinin në sheshin e flamurit,” *Politiko*, 12.03.2022. Në dispozicion në: <https://politiko.mk/2022/03/12/ahmeti-me-porosi-nga-vlora-shoket-qe-rane-neper-beteja-enderronin-te-vinin-ne-sheshin-e-flamurit/>

61 Anna Di Lellio and Stephanie Schwandner-Sievers, “The Legendary Commander: the construction of an Albanian master-narrative in post-war Kosovo,” *Nations and Nationalism* 12, no. 3 (2006): 513-529.

62 Boris Pavelic et al., “Ethnic Divisions Set in Stone,” *Balkan Insight*, 25.06.2013. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2013/06/25/ethnic-divisions-set-in-stone/>

Neofotistos e quan tendencën e përkujtimit të luftëtarëve të rënë të UÇK-së si një mënyrë për të krijuar "dëshmorët e kombit shqiptar".⁶³ Vendet e para të përkujtimit për luftëtarët e rënë u inicuan nga miqtë dhe të afërmit me mbështetjen financiare të komunitetit shqiptar nga Maqedonia, si dhe nga jashtë, dhe monumentet e luftëtarëve të UÇK-së përfaqësonin një mundësi për mbledhjen e fondeve dhe në të njëjtën kohë të forcohen lidhjet me diasporën shqiptare.⁶⁴ Monumentet ndodhen kryesisht në sheshet kryesore të fshatrave dhe pranë rrugëve kryesore dhe janë bërë "pjesë integrale e peizazhit nëpër të cilin shqiptarët lëvizin fizikisht çdo ditë".⁶⁵ Një nga simbolet që përsëritet më shpesh në arkitekturën monumentale shqiptare pas vitit 2001 është shqiponja e zezë me dy kokë nga flamuri i Shqipërisë. Shembulli më i fundit i monumentit, i ngritur në vitin 2022, u vendos në majë të një kulle 20 metra në Likovë afër Kumanovës, për të cilën do të flasim më vonë në tekst. Rrëfimi për luftëtarët e rënë të UÇK-së përfshin gjithashtu referenca fetare ku atyre u atribuohet pastërtia. Sipas Rifit, roli i fesë në përkujtimet e luftëtarëve shqiptarë është i dukshëm në atribuimin e aspekteve të martirizimit fetar për luftëtarët që bëhen kështu dëshmorë të kombit.⁶⁶

BDI dhe shoqata e veteranëve UÇK morën rolin e rojeve të kujtimit të luftës së armatosur në Maqedoni menjëherë pas përfundimit të armiqësive në vitin 2001. Në këtë kulturë të kujtesës, kryengritja e armatosur e vitit 2001 përfaqëson vazhdimësinë me luftën mbarëshqiptare rajonale përgjatë historisë. Monumentet e reja luajnë rolin e një kujtese alternative nga poshtë, sepse ato pothuajse ekskluzivisht promovojnë narrativa që janë në kundërshtim me versionin zyrtar, maqedonas etnik, të konfliktit të armatosur të vitit 2001. Përveç neverisë që vjen nga publiku etnik maqedonas, monumentet mobilizojnë komunitetin shqiptar të kujtesës dhe e bashkojnë atë rreth narrativave historike etnocentrike dhe një episodi të supozuar të suksesshëm në fushatën ushtarake të UÇK-së në Maqedoni. Megjithatë, pavarësisht nga neveria e publikut maqedonas, nuk pati raste të heqjes apo shkatërrimit të monumenteve kushtuar luftëtarëve të UÇK-së, për dallim nga reagimet shumë më agresive ndaj përkujtimeve në vendet e pritës.

63 Neofotistos, "The Construction".

64 Nadège Ragaru, "Macedonia: Between Ohrid and Brussels". *Cahiers de Chaillot* (2008): 41-60.

65 Neofotistos, "The Construction".

66 Paul Reef, "Macedonian Monument Culture Beyond 'Skopje 2014,'" *Südosteuropa* 66, no. 4 (2018): 451-480.

4. Interseksionet

4.1. Vendet e mosmarrëveshjeve

Përkujtimet e luftës së armatosur ndërmjet forcave shtetërore dhe UÇK-së zhvillohen në domenin e dy bashkësive më të mëdha etnike, maqedonase dhe shqiptare. Rrallëherë ka një mbivendosje midis këtyre dy kulturave të kujtesës, qoftë edhe gjeografikisht. Megjithatë, ka përkujtime që zhvillohen në zona gjeografike që i përkasin një bashkësie të ndryshme etnike. Shumica mbahen në vende të pritave në veri-perëndim të shtetit, ku UÇK sulmoi forcat e armatosura shtetërore. Në këtë punim, aktivitetet përkujtimore në vendet e pritës konsiderohen si "mosmarrëveshje", sipas kuptimit të Mannegren Selimoviq. Vendet e mosmarrëveshjes paraqesin marrëdhënie asimetrike të fuqisë midis aktorëve të ndryshëm shoqërorë dhe politikë, por ato mundësojnë gjithashtu negocimin dhe ristrukturimin e këtyre marrëdhënieve, duke ndryshuar narrativat për ngjarjet e së kaluarës dhe duke i dhënë kuptim të tashmes.⁶⁷

Përkujtimet në vendet e pritës në Vjecë dhe Karpalak afër Tetovës janë aktivitetet përkujtimore më domethënëse kur bëhet fjalë për pritën. Vizitat në vendet e pritës filluan në vitin 2003, kur familjarë, miq, shokë të të rënëve dhe anëtarë të shoqatave të veteranëve filluan të organizojnë përkujtimore për pjesëtarët e rënë të forcave shtetërore dhe të vendosin pllaka përkujtimore, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të KOM, komunave dhe autoriteteve shtetërore. Pllakat përkujtimore u shkatërruan menjëherë pas ceremonive përkujtimore, duke nxitur debate publike për konfliktin latent etnik dhe kundër pajtimit ndëretnik.

Përkujtimet e para në vendin ku u varrosën ushtarët maqedonas të vrarë afër fshatit Vejcë u mbajtën në vitin 2002, kur u vendosën pllakat e para përkujtimore dhe objektet përkujtimore në vendlindjet e ushtarëve të rënë në zonën e Manastirit. Pikërisht atëherë

67 Johanna Mannegren Selimovic, "Making Peace, Making Memory: Peacebuilding and Politics of Remembrance at Memorials of Mass Atrocities," *Peacebuilding* 1, no. 3 (2013): 334-348.

u bë e qartë se kujtimi i bashkëqytetarëve të rënë është i rëndësishëm për komunitetet lokale. Për shembull, në vitin 2009, komuna e Makedonska Kamenicës e emëroi shkollën fillore në qytet me emrin Mile Janevski-Xhingar, një nga pjesëtarët e rënë të forcave të armatosura, dhe e caktoi ditën në të cilën ndodhi prita si ditë e shkollës. Monumenti kushtuar të vdekurve pranë Vejcës ndodhet në qendër të Manastirit, ndërsa në Draçevë të Shkupit që nga viti 2013 ka shesh qendror, park dhe monument kushtuar ushtarëve të rënë maqedonas.

Komuniteti shqiptar reagoi negativisht ndaj përkujtimeve në vendet e pritave. Gjatë përkujtimit pranë Vejcës në vitin 2003, shqiptarët vendas bllokuan kolonën e pjesëmarrësve. Edhe pse çdo vit ngriheshin pllaka përkujtimore, ato janë shkatërruar menjëherë pas përkujtimeve. Mediat u interesuan sërish për përkujtimet vjetore pranë Vejcës në vitin 2010, kur familjet e ushtarëve të rënë maqedonas dhe shoqata e veteranëve "Dostoinstva" vendosën një pllakë përkujtimore, e cila u shkatërrua menjëherë pas ceremonisë. Një nga shoqatat e shumta të veteranëve të krijuar pas vitit 2001, "Dostoinstva" u shndërrua në një parti politike të djathtë në vitin 2011, me të drejtat e veteranëve të luftës të plagosur dhe invalidë dhe familjeve të tyre si pjesë e programit politik. Partia gradualisht u profilizua si roje e kujtimit të pjesëtarëve të rënë të forcave shtetërore. Anëtarët e "Dostoinstva", shumica prej tyre ish-pjesëtarë të forcave të armatosura shtetërore, marrin pjesë në të gjitha përkujtimet e përmendura vjetore në vendet e pritës, por advokojnë forma të tjera përkujtimore, si dhe pajtimin. Aktivitetet e tyre paraqesin një kombinim të promovimit të kujtimit të "mbrojtësve" të rënë maqedonas dhe, në një shkallë më të vogël, propozimeve për iniciativa alternative që synojnë lidhjen e dy komuniteteve etnike të kujtesës. Partia i ka bërë disa kërkesa institucioneve shtetërore për të nderuar dhe kujtuar aspekte të ndryshme që lidhen me Forcat e Armatosura shtetërore. Në vitin 2021, presidentit Steve Pendarovski iu kërkua të dekoronte tre gjeneralë të vdekur me medalje për pjesëmarrjen e tyre në konfliktin e vitit 2001.⁶⁸

Këtu mund t'i kthehemi përkujtimit të parë dhe deri më tani të vetëm të përbashkët në Maqedoninë e Veriut pas konfliktit. Në dhjetor 2018, pas një sërë shkëmbimesh publike opinionesh për konfliktin, Stojançe Angelov, themelues dhe president i "Dostoinstva" dhe

68 "Dostoinstvo podnese inicijativa za odlikuvanje na trojca počinati generali," *Fokus*, 16.02.2021. Në dispozicion në: <https://fokus.mk/dostoinstvo-podnese-inicijativa-za-odlikuvane-na-trojtsa-pochinati-general/>

ish-komandant i forcave speciale të policisë, dhe Abedin Zimberi, ish-komandant i UÇK-së, së bashku përkujtuan viktimat civile të Konfliktit të vitit 2001 në varrezat në Likovë. Edhe pse të dy ishin në poste zyrtare në atë kohë, shteti nuk organizoi përkujtimoren. Në një tekst që shkroi pas përkujtimit, Angelov argumentoi se pikëpamjet e ndryshme të së kaluarës nuk duhet të jenë pengesë për marrëdhëniet ndëretnike në të ardhmen. Angelov dhe Zimberi planifikuan ngjarje të ngjashme në varret e viktimave civile maqedonase, të cilat u anuluan për shkak të publicitetit negativ rreth përkujtimit të mëparshëm.⁶⁹

Përkujtimet në vendin e pritës në Karpalak janë një shembull i historisë së konfliktit me politikën shtetërore. Në gusht të vitit 2004, familjet dhe miqtë e të vrarëve në pritë bojkotuan kryeministrin e atëhershëm Vllado Buçkovski i cili erdhi në përkujtim dhe e njëjta gjë ndodhi vitin e ardhshëm. Buçkovski, në këmbim, premtoi të ndërtojë një monument kushtuar ushtarëve maqedonas që u vranë në Karpalak. Çështja e një monumenti të mundshëm pranë Karpalakut u rishfaq në vitin 2019 kur zyrtarët shtetërorë vunë në dukje se do të ishte e mundur të ngrihej një monument pasi vendi të bëhej anëtar i aleancës së NATO-s. Maqedonia e Veriut u bë anëtare e NATO-s në vitin 2020, por nuk ka plane për një monument pranë Karpalakut. Arsyet e vonës mund të jenë natyra e diskutueshme e vendit të pritës, e cila është shoqëruar me raste të shumta të shkatërrimit të pllakave përkujtimore dhe shkrimit të mbishkrimeve të ONA-s apo UÇK-së gjatë viteve të fundit.

Rastet e shkatërrimit të pllakave përkujtimore ringjallën diskutet publike kritike ndaj pajtimit në çdo formë dhe kërcënuan ndjenjën e sigurisë tek qytetarët e Maqedonisë së Veriut. Incidentet e dhunës dhe shkatërrimit në vendet memoriale funksionojnë si "shkelës të paqes" (*peace-breakers*) në kontekstin maqedonas pas konfliktit.⁷⁰ Këto raste tregojnë gjithashtu se si grupet radikale dhe aktivitetet e tyre mund të ndryshojnë ndjeshëm diskursin publik mbi konfliktin e armatosur dhe armëpushimin. Megjithatë, perceptimet publike për këto akte nuk janë aq uniforme sa mund të duken nga mbulimi mediatik. Një studim i vitit 2022 zbuloi se të rinjtë me kombësi maqedonase dhe shqiptare nga Tetova dënojnë dhunën që ndodh në afërsi të Karpalakut pas përkujtimit dhe e shohin atë si

69 Stojanče Angelov, "Vo 2001 izgubivme site, izgubi Makedonija," *Mkd.mk*, 16.12.2018. Në dispozicion në: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/generalot-angelov-vo-lipkovo-vo-2001-izgubivme-site-izgubi-makedonija>

70 Gëzim Visoka: "Everyday Peace Capture: Nationalism and the Dynamics of Peace after Violent Conflict," *Nations and Nationalisms* 26, no. 2 (2020): 431-446.

shpërthime të grupeve të vogla radikale.⁷¹ Në nënkapitullin vijues, analiza do të fokusohet në forma të tjera të kontakteve ndëretnike që nuk përfshijnë domosdoshmërisht dhunë të drejtpërdrejtë.

4.2. Zonat e kontaktit

Aktivitetet përkujtimore në qytetet dhe komunat multietnike të Maqedonisë së Veriut, ose "zonat e kontaktit" siç i quan Brown, janë pa dyshim të ndryshme nga ato në vendlindjet e anëtarëve të forcave të armatosura maqedonase ose në vendet me popullsi shumicë shqiptare. Në këto vende, praktikat e përditshme kryesisht sillen rreth kontakteve formale dhe joformale dhe negociatave ndëretnike të dispozitave të MKO, kornizave ligjore dhe kulturave të kujtesës. Në diskutim janë edhe produktet e lojrave, lëshimeve dhe tensioneve ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe lokal, agjendave dhe institucioneve. Në përgjithësi, këto vende ilustrojnë instrumentalizimin politik të kujtesës së konfliktit të armatosur në Maqedoni dhe prodhimin e narrativave etnocentrike të historisë dhe kujtesës në hapësirën publike. Ky nën-kapitull identifikon modelet dominuese që kanë shënuar transformimin e tensioneve ndëretnike nga para konfliktit të armatosur në fushën e menaxhimit të kujtesës pas vitit 2001. Këto modele përfshijnë: armatosjen e kujtesës dhe injorimin e simboleve të grupeve të tjera etnike, si dhe shënimin e territorit etnik përmes memorialeve dhe monumenteve.

Për shumë aktorë në Maqedoninë e Veriut, lufta gjatë konfliktit të armatosur dhe lufta për trashëgiminë e tij janë lojra me shumën zero. Një shembull i shkëlqyer i kësaj tendence është rasti i fshatit Shemshevë afër Tetovës, ku BDI organizoi përkujtimet e para të fillimit të konfliktit. Në janar të vitit 2003, rreth 200 nxënës të nacionalitetit maqedonas filluan të bojkotojnë shkollën fillore sepse autoritetet nuk e hoqën statujën e Jumni Jonuzit, një luftëtar të UÇK-së, nga prona e shkollës ku qëndronte që nga përfundimi i konfliktit të armatosur. Pa respektuar parimet e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, autoritetet lokale ndryshuan emrin e shkollës, e cila quhej Dame Gruev, sipas heroit kombëtar maqedonas aktiv në luftën kundër Perandorisë Osmane në Jumni Jonuz.⁷²

71 CONNEKT Country Reports, në përgatitje.

72 Emil Zafirovski, "Šemševci kje ja bojkotiraat nastavata i vo vtoroto polugodie," *Dnevnik*, 22.01.2003.

Dinamikat në Tetovë, ku përfaqësuesit shqiptarë kanë dominuar në këshillin komunal që nga viti 2001, ndjekin një model të ngjashëm të fshirjes së shenjave dhe monumenteve të identitetit joshqiptar. Për shembull, në vitin 2010, autoritetet e qytetit i hoqën përkohësisht nga qendra e qytetit statujat e partizanëve të Tetovës nga Lufta Popullore Çlirimtare dhe nuk i kthyen kurrë në vendin e tyre.⁷³ Shembujt e analizuar më parë të shkatërrimit të monumenteve dhe pllakave përkujtimore dhe përpjekjet për të parandaluar përkujtimet e pjesëtarëve të rënë të forcave të armatosura shtetërore janë gjithashtu shembuj të këtij modeli në kontekstin e memorializimit. Në mesin e viteve 2000, shqiptarët vendas penguan një grup maqedonasish të përkujtonin dy civilë që u vranë nga UÇK-ja në gusht të vitit 2001, teksa punonin si roje sigurie në motelin "Brioni" në Çelopek. Shqiptarët vendas vazhdojnë të pengojnë rindërtimin e motelit dhe vendit memorial.⁷⁴

Një model i ngjashëm u zhvillua në qytetin multietnik të Strugës në pjesën jugperëndimore të vendit. Pas ndryshimeve në organizimin territorial lokal që u dha shqiptarëve etnikë shumicën në qytet, Ramiz Merko nga BDI u bë kryetar komune në vitin 2005. Menjëherë pas zgjedhjeve, administratës së qytetit i erdhi ideja për të ngritur një monument për anëtarin e vrarë të këshillit të qytetit, Nuri Mazar-Struga, i cili ishte edhe anëtar i UÇK-së. Autoritetet e qytetit miratuan propozimin për monumentin, megjithatë, vendimi u mor pa parimin e nevojshëm të shumicës së dyfishtë që përcakton MKO. Ndonëse monumenti përfundimisht u parandalua, Ragaru vë në dukje se iniciativa të tilla shqetësojnë banorët vendas të nacionalitetit maqedonas, duke e quajtur këtë mënyrë të instrumentalizimit të së kaluarës për të treguar mbizotërimin politik të një grupi etnik me "homogjenizim etnik".⁷⁵

Një shembull tjetër i armatosjes së kujtimit të konfliktit ka ndodhur në rrethinën e Kumanovës. Gjegjësisht, gjatë viteve 2003 dhe 2004, mediat raportuan për raste të banorëve lokalë të nacionalitetit maqedonas të cilët ishin detyruar të përkuleshin para monumentit të luftëtarëve të rënë të UÇK-së në fshatin Matejçe për t'u lejuar të kthehen në shtëpitë e tyre në fshatrat përreth.⁷⁶ Në afërsi të Shkupit, një grup burrash me uniforma

73 Dona Dimov-Markovska, "Ilustracija na primenata na ORD na lokalno nivo vo Tetovo i Tearce," in *Ohridski ramkoven dogovor: Studii na slučaj* (Skopje: MCMS, 2011), 131-136.

74 Z. Andonov, "16 godini čekame Pravda za Svete i Boge, velat semejstvata na ubienite kaj Brioni," *Sakam da kažam*, 26.08.2017. Në dispozicion në: <https://sdk.mk/index.php/dopisna-mreza/16-godini-cekame-pravda-za-svete-boge-velat-semejstvata-na-ubienite-kaj-brioni/>

75 Më shumë për këtë: Ragaru, "Macedonia", 26.

76 "Poklonenie pred ONA, vleznica za doma," *Dnevnik*, 09.02.2004.

të UÇK-së bllokuan një rrugë lokale një orë për të festuar pesëvjetorin e "fitores" së UÇK-së. Në vitin 2020, banorët vendas të vendbanimit në Dolno Orizar të nacionalitetit shqiptar mblodhën mjete për vendosjen e një pllake të madhe përkujtimore me simbolet e ONA dhe UÇK-së dhe e vendosën në hyrje të vendbanimit të quajtur ilegalisht Arben Bajrami, sipas një anëtarit të UÇK-së.

Tensionet rreth kujtimit të konfliktit të vitit 2001 u shfaqën edhe në kryeqytet. Pas vetos greke për pranimin e Maqedonisë në NATO në vitin 2008, qeveria e VMRO-DPMNE-së nisi një projekt për të riemërtuar kombin përmes përmbajtjeve të reja kujtuese në kryeqytetin Shkup. Ky projekt qendror, i quajtur "Shkupi 2014", rezultoi me më shumë se 130 monumente dhe statuja në qytet. Monumentet dhe arkitektura kryesisht paraqesin aktorë historikë të kombësisë maqedonase me vetëm disa figura nga prejardhje të tjera etnike, fetare dhe kulturore, të cilët u përfshinë në fazat e mëvonshme të projektit. Megjithatë, sot ka edhe shumë akuza dhe pretendime për shkelje të procedurave standarde nga ana e qeverisë gjatë porositjes së monumenteve dhe statujave.⁷⁷

Qeveria nën drejtimin e VMRO-DPMNE-së, në kuadër të projektit "Shkupi 2014" e ngriti monumentin "Mbrojtësit e Maqedonisë". Monumenti përshkruan katër anëtarë të forcave të armatosura shtetërore në një stil realist, të zhveshur në pjesën e sipërme të trupit dhe afër njëri-tjetrit duke mbajtur një rruzull dukshëm të plasarit. Në monument ka edhe një pllakë me emrat e të gjithë pjesëtarëve të forcave shtetërore që u vranë në vitin 2001. Monumenti i mbrojtësve ndodhet në parkun në qendër të qytetit, i cili mban emrin e partizaneve nga Lufta e Dytë Botërore dhe ndodhet pikërisht përballë Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Qeveria zyrtarisht e zbuloi monumentin më 23 tetor 2011, në përvjetorin e themelimit të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase 1893, sipas së cilës u emërua partia VMRO-DPMNE. Që nga themelimi i saj në vitin 1990, VMRO-DPMNE pretendon vazhdimësinë me organizatën antiosmane nga shekulli i 19-të dhe themeloi ditën e lartpërmendur të themelimit si festë kombëtare në vitin 2007, në të cilën u zbulua një monument për pjesëtarët e forcave shtetërore të vrarë në konfliktin e vitit 2001.

Projekti "Shkupi 2014" dhe monumentet e tij janë shembull i shënimit të kufijve simbolikë

77 Më shumë për këtë në: *Analiza na Zakonskata regulative i sprovedenite postapki za izgradba na spomen obeležja vo ramki na proektot Skopje 2014* (Skopje: Transparency International Macedonia, 2011).

ndërmjet bashkësive etnike në Shkup.⁷⁸ Repertori i kujtimeve dhe ngjarjeve që kanë të bëjnë me historinë dhe kulturën maqedonase në anën e djathtë të lumit Vardar tregojnë për vendbanimet me popullsi maqedonase në Shkupin e sotëm. BDI-ja, partnerët e koalicionit VMRO-DPMNE gjatë projektit "Shkupi 2014" shënuan në mënyrë të ngjashme bregun e majtë të lumit. Në nëntor 2006, Komuna e Çairit dhe BDI hapën sheshin Skënderbe në Shkup në ditën e flamurit shqiptar.⁷⁹ Murali qendror në shesh paraqet shkrimin historikë të heronjve dhe martirëve shqiptarë, si një rrëfim mjeshtëror për luftëtarët e rënë të UÇK-së, por edhe në përputhje me modelin etnocentrik të projektit "Shkupi 2014". Sheshi Skënderbe shërben si një platformë për "artikulimin e fuqisë simbolike që anëtarët e komunitetit shqiptar kanë mbledhur gjatë historisë deri më sot."⁸⁰

4.3. Përshtatjet etnike

Termi "përshtatje etnike" përdoret në këtë punim për të diskutuar modelet e ndërveprimit funksional në shoqëritë pas konfliktit.⁸¹ Në këtë pjesë të punimit, aplikojmë konceptin e përshtatjes etnike në aktivitetet përkujtimore në Maqedoni në nivel të elitave politike. Rastet pak a shumë të suksesshme të akomodimit etnik rreth çështjeve që lidhen me kujtesën e konfliktit të armatosur të vitit 2001 varen nga disa faktorë kontekstualë.

Rasti i qytetit multietnik të Kumanovës në verilindje të vendit tregon disa rezultate të mundshme të përshtatjes etnike në nivel të elitave lokale. Siç vëren Dimova, hapësirat që flasin për histori të ndryshme në Kumanovë kanë qenë objekt konflikti që nga fillimi i viteve nëntëdhjetë e deri para konfliktit të vitit 2001.⁸² Ndjenja e humbjes së privilegjeve

- 78 Për një pasqyrë të debatit akademik, të shihet: Naum Trajanovski, "'Skopje 2014' Reappraised: Debating a Memory Project in North Macedonia," in *Europeanisation and Memory Politics in the Western Balkans*, eds. A. Milošević and T. Trošt (London – New York: Palgrave Macmillan, 2021), 151-177.
- 79 Nadëge Ragaru, "The Political Uses and Social Lives of 'National Heroes': Controversies over Skanderbeg's Statue in Skopje," *Südosteuropa* 56, no. 4 (2008): 528-555.
- 80 Vasiliki Neofotistos, "Commemorations and the Re-invention of a City: Alternative Memories of the Past in North Macedonia," in *Cultures and Politics of Remembrance: Southeast European and Balkan Perspectives*, eds. N. Trajanovski et al. (Skopje: forumZFD – Institute of Ethnology and Anthropology – Institute of National History, 2021), 89-96.
- 81 Cvete Koneska, *After Ethnic Conflict: Policy-making in Post-conflict Bosnia and Herzegovina and Macedonia* (Farnham: Ashgate, 2014).
- 82 Rozita Dimova, "Consuming Ethnicity: Loss, Commodities, and Space in Macedonia," *Slavic Review* 69, no. 4 (2010): 859-881.

klasore dhe etnike tek banorët e kombësisë maqedonase para shpërbërjes së Jugosllavisë krijoi terren pjellor për nacionalizëm dhe qëndrime negative ndaj bashkëqytetarëve të kombësisë shqiptare. Edhe pse shumë paragjykime ekzistonin më parë, statusi i përmirësuar i shqiptarëve etnikë në Maqedoninë post-jugosllave ringjalli stereotipet etnike. Megjithatë, gjatë periudhës më të vështirë të vitit 2001, autoritetet lokale treguan një ndjenjë të qartë të përgjegjësisë qytetare dhe aftësinë për të de-përshkallëzuar tensionet. Megjithëse qyteti shmangu armiqësi të mëdha, pati disa konflikte të armatosura në zonë. Gjithashtu, të gjithë qytetarët e Kumanovës pa dallim etnike kanë pësuar nga mbyllja e digës afër Likovës nga UÇK-së gjatë konfliktit. Siç vë në dukje Phillips, pikërisht në Kumanovë kryetari Slobodan Kovačevski dhe Feriz Dervishi, i cili drejtonte komisionin komunal për marrëdhëniet ndëretnike, punuan pa u lodhur së bashku për të parandaluar përshkallëzimin në qytet gjatë disa javësh shkëmbim zjarri në zonat përreth.⁸³

Edhe pas përfundimit të konfliktit, elitat lokale vazhduan t'i qasen çështjeve të ndjeshme që lidhen me kujtesën e konfliktit me një ndjeshmëri të ngjashme. Sipas regjistrimit të vitit 2022, rreth 55 për qind e nacionalitetit maqedonas dhe pothuajse 26 për qind e shqiptarëve jetojnë në Kumanovë, përveç komuniteteve të rëndësishme serbe dhe rome. Përbërja e këshillit komunal korrespondon me strukturën etnike të popullsisë. Në vitin 2008, këshilli miratoi një program komunal që përfshin planet e projektit për dy monumente, njëri prej të cilëve i kushtohet mbrojtësve maqedonas nga viti 2001 dhe tjetri për luftëtarët e rënë të UÇK-së. Në atë kohë ishte i vetmi rast i tillë në tërë territorin e Maqedonisë.⁸⁴ Për më tepër, autoritetet komunale emërtuan disa rrugë me numra përpara zgjedhjeve lokale të vitit 2009, duke shmangur emrat specifike etnikisht.

Zhvillimet e fundit në dhe rreth Kumanovës, megjithatë, sugjerojnë se përshtatja etnike lokale lehtë mund të ndërpritet. Në maj të vitit 2015, pati një shkëmbim zjarri midis forcave të sigurimit të shtetit dhe Ushtrisë Kombëtare Shqiptare (AKSH, *Armata Kombëtare Shqiptare*), një grup i armatosur kundër MKO dhe regjimit të pasluftës në Kosovë, e cila përfundoi me tetë policë të vrarë dhe 37 të plagosur si dhe 10 pjesëtarë të AKSH-së të plagosur. Si pasojë e ngjarjes janë arrestuar 28 rebelë të kombësisë shqiptare me akuzën

83 Phillips, *Macedonia*, 112-113.

84 "Ulogata na megjuetničkiot dijalog vo procesot na odlučuvanje vo Opština Kumanovo," in *Ohridski ramkoven dogovor: Studii na slučaj* (Skopje: MCMS, 2011), 137-142.

e terrorizmit.⁸⁵ Vetëm një muaj para shkëmbimit të zjarrit në Kumanovë, një grup me simbole të UÇK-së pushtoi stacionin policor në Goshinac në komunën e Likovës, jo shumë larg kufirit Kosovë-Serbi, me kërkesa për krijimin e një shteti shqiptar brenda Maqedonisë së Veriut. Grupi në mënyrë të paligjishme ka siguruar një sasi të madhe armësh zjarri dhe municioni në stacionin policor, të cilat më pas janë gjetur në Kumanovë, pas të shtënave të lartpërmendura në maj të vitit 2015.⁸⁶

Përshkallëzimi i dhunës dhe ndalimi i zhvillimit të projekteve përkujtimore çuan në një përkeqësim të opinionit publik për monumentet në Kumanovë. Tashmë në vitin 2011, për shembull, rreth 65 përqind e banorëve maqedonas të Kumanovës kishin një mendim negativ për MKO-në si një marrëveshje që supozohet se privilegjonte një komunitet etnik, ndërsa grupet e tjera etnike në qytet kishin mbi 55 përqind të përgjigjeve me qëndrime negative ndaj marrëveshjes së paqes dhe rregullimet institucionale që prezantoi.⁸⁷ Autoritetet lokale nuk arritën të vazhdonin me politikat e fundit të viteve 2000 dhe ndaluan ndërtimin e dy monumenteve të përmendura më parë. Siç vë në dukje Konesca, mungesa e zbatimit të vendimeve të miratuara është një nga mënyrat se si përshtatja etnike mund të kthehet në rezistencë etnike në mesin e elitave politike.⁸⁸ Me fjalë të tjera, rezistenca është rezultati i kundërt i përshtatjes dhe i referohet dështimeve të elitave për të arritur marrëveshje ose kompromis. Sidoqoftë, në praktikë, ndryshimi midis përshtatjes dhe rezistencës nuk është fjalë për fjalë binare, por bie në një gamë më të gjerë tendencash për të bashkëpunuar, kompromentuar ose për t'i rezistuar grupit tjetër.⁸⁹ Sfera e kujtesës në Maqedoninë e pas-konfliktit është një shembull i mirë se si elitat politike mund të arrijnë një kompromis për një temë pa u pajtuar plotësisht për një tjetër. Inaugurimi i një kulle përkujtimore 20 metra të lartë kushtuar luftëtarëve të UÇK-së në Sllupçan afër Likovës ilustron këtë dinamikë. Likova, siç u përmend më herët, ishte një pikë kyçe në betejat rreth Kumanovës. Që nga fundi i konfliktit në gusht të vitit 2001, për BDI-në

85 CONNEKT Country Reports. *Framing Violent Extremism in the MENA Region and the Balkans: North Macedonia* (European Institute of the Mediterranean, 2020).

86 Ivan Stefanovski, "A Bottom-up Perspective on Peace and Security in North Macedonia: Turbulent Violent Past versus Uncertain Future?" in *Peace and Security in the Western Balkans: A Local Perspective*, eds. N. Džuverović and V. Stojarová (London – New York: Routledge, 2023), 70-87.

87 Marjan Mladenovski, "Ramkovniot dogovor, etničkata distanca i multikulturalizmot: Fokus na opština Kumanovo," in *Ohridski ramkoven dogovor: Studii na slučaj* (Skopje: MCMS, 2011), 25-35.

88 Konesca, *After Ethnic Conflict*, 3-38.

89 Konesca, *After Ethnic Conflict*, 12.

fshati ka luajtur rolin e një fortese kujtuese për luftëtarët e UÇK-së dhe viktimat civile të konfliktit të armatosur.

Në vitin 2012, Fatmir Besimi, ministër i Mbrojtjes nga BDI, vendosi lule në kullën përkujtimore në Sllupçan, afër Likovës. Gjesti i tij ishte akti i parë i mbështetjes për monumentin e luftëtarëve të UÇK-së nga një përfaqësues i lartë shtetëror.⁹⁰ Vendosija e luleve shkaktoi reagime negative në media dhe institucionet shtetërore, siç ishte rasti me përkujtimin e mëvonshëm, tashmë të përmendur në këtë tekst, të përbashkët me Angelovin dhe Zimberin në vitin 2018, po në Likovë. Megjithatë, megjithëse pati reagime të ngjashme negative për kullën përkujtimore të zbuluar në vitin 2021, diskurset institucionale sugjerojnë se elitat politike arritën një kompromis mes tyre edhe para ndërtimit të monumentit. Komuna e Likovës ka ndërtuar një kullë mbi 200 mijë euro pa respektuar procedurat parlamentare dhe Ligjin për monumente.⁹¹ Në të kundërtën, kryetari i komunës, Erkan Arifi, pohon se monumenti është monumenti i parë dhe i vetëm kushtuar luftëtarëve të UÇK-së që ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme dhe është regjistruar zyrtarisht.⁹² Përveç kësaj, në përfundimin e kullës morën pjesë edhe shumë përfaqësues të shtetit nga BDI, edhe pse vetëm një javë më parë partia ishte riemërtuar si Partia e Gjelbër.

Mediat maqedonase e interpretuan zbulimin e monumentit si një tjetër dëshmi të mbështetjes së BDI-së në kapitalin simbolik nga viti 2001. Monumenti në Kumanovë çoi në mobilizimin e sindikatës së policisë rreth iniciativës për një monument të ri për mbrojtësit e rënë maqedonas, i cili do të përfaqësonte "trajtimin e drejtë" të heronjve maqedonas dhe sakrificën e tyre për shtetin maqedonas.⁹³ Nisma të tilla nga poshtë-lart kanë pak shanse për të ndikuar në rezultatet e kompromiseve midis eliteve.

90 Mirjana Spasovska, "Namesto pomiruvanje, nov razdor," *Radio Slobodna Evropa*, 16.08.2012. Available at: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/24678840.html>

91 Sotir Trajkov, "Sobranieto bez programa za memorijalni spomenici," *Telma*, 03.05.2022. Available at: <https://telma.com.mk/2022/05/03/sobranieto-bez-programa-za-memorijalni-spomenici/>

92 "Zelenata agenda na DUI počnuva so izgradba na spomenik na ONA vo Lipkovo," *360stepeni*, 11.06.2021. Në dispozicion në: <https://360stepeni.mk/zelenata-agenda-na-dui-pochnuva-so-izgradba-na-spomenik-na-ona-vo-lipkovo/?fbclid=IwAR10Bj5vjCUOu6xVaxObK4iLSTIAUYk3hA3AftdkiKTbG2k8udkF9XOWh9o>

93 "Poradi spomenikot na UÇK vo Lipkovo se povlekuva inicijativata za izgradba na spomen-obeležje na zaginatite braniteli," *Mkd.mk*, 09.05.2022. Në dispozicion në: <https://time.mk/c/47f2c2ebec/poradi-spomenikot-na-uck-vo-lipkovo-se-povlekuva-inicijativata-za-izgradba-na-spomen-obelezje-na-zaginatite-braniteli.html>

4.4. Marrëveshja

Përvjetori i nënshkrimit të MKO është një tjetër zonë e interseksioneve mes elitave etnike maqedonase dhe shqiptare. Nëse rastet e analizuara më parë sugjerojnë rregullime apo rezistencë pas dyerve të mbyllura, përkujtimet zyrtare të përvjetorëve të nënshkrimit të marrëveshjes janë kthyer në platforma për "pajtimin ritual të elitave".⁹⁴ Kujtesa për MKO është shndërruar në monedhë për elitat politike maqedonase dhe shqiptare, të cilat përdorin shënimin e përvjetorit për të demonstruar kapacitetin e tyre për të përshtatur kuptimet e tyre për ngjarjet e kaluara dhe tregimet historike me "pritshmëritë e të huajve si këmbim për përfitim politik dhe ekonomik."⁹⁵ Qëndrimet e elitës ndaj MKO nuk kanë qenë gjithmonë aq pozitive dhe uniforme sa sot. Për shembull, në mesin e aktorëve politikë të nacionalitetit maqedonas, MKO ka qenë subjekt i debateve të nxehta që nga gushti 2001. Agjentë të ndryshëm të kujtesës përdorin përvjetorët e MKO për të promovuar interpretimet e preferuara të konfliktit dhe marrëveshjes së paqes që i dha fund atij.⁹⁶

Në vitet e para pas konfliktit të armatosur, dy partitë më të mëdha politike të maqedonasve etnikë, Bashkimi Social Demokrat i Maqedonisë (BSDM), atëherë në pushtet, dhe opozita VMRO-DPMNE, zhvilluan pikëpamje të kundërta për konfliktin e armatosur, shkaqet dhe marrëveshjen e paqes. Qeveria BSDM-BDI, në pushtet nga viti 2002 deri në vitin 2006, nxiti zbatimin e MKO në kontekstin e debateve, përkujtimeve dhe narrativave publike për konfliktin. Përfaqësuesit shtetërorë nga BSDM morën pjesë në përkujtimoret e pjesëtarëve të forcave të armatosura shtetërore, siç ishte Karpalak, dhe nuk e shënuan përvjetorin e MKO-së në vitet e para të pasluftës.

Një nga përkrasësit kryesorë të marrëveshjes së paqes gjatë fillimit të viteve 2000 ishte Boris Trajkovski nga VMRO-DPMNE, president i Maqedonisë nga viti 1999 deri në vitin 2004. Trajkovski e artikuloi diskursin për të ardhmen e përbashkët të dy bashkësive etnike

94 Për „pajtimin ritual të elitave” në ish Jugosllavi, të shihet: Vjekoslav Perica, *Pomirenje i posljedji dani. Balkanske nacije u mitovima i muzejima slave, stida i srama* (Beograd: Biblioteka XX vek, 2021).

95 Lea David, "Lost in Transaction in Serbia and Croatia: Memory Content as a Trade Currency," in *Replicating Atonement: Foreign Models in the Commemorations of Atrocities*, ed. M. Gabowitsch (London – New York: Palgrave Macmillan, 2017), 73-97.

96 Më shumë për këtë në: Lidija Georgieva, Naum Trajanovski, and John Wolffe, "Memory Regimes and Commemorative Practices of the Good Friday Agreement (1998) and the Ohrid Framework Agreement (2001)," *Religious Diversity in Europe: Mediating the Past to the Young*, eds. R. Altnurme et al. (London: Bloomsbury Academic, 2022), 137-158.

si perspektivë të vetme për shtetin. Rreth përvjetorit të parë të marrëveshjes, Trajkovski deklaroi se MKO "nuk është një dokument i përsosur, por është përgjigja më e përshtatshme politike ndaj krizës me të cilën jemi përballur".⁹⁷ Ai e promovoi këtë diskurs në përkujtimet kombëtare që nuk kishin lidhje me konfliktin e armatosur të vitit 2001, si për shembull Ilinden apo Dita e Republikës.⁹⁸ Pas vdekjes së Trajkovskit në një aksident avioni në vitin 2004, nuk kishte asnjë figurë tjetër nga e djathta politike nën udhëheqjen e VMRO-DPMNE-së që të promovonte MKO dhe konsolidimin pas konfliktit në Maqedoni.

VMRO-DPMNE e konfirmoi zyrtarisht MKO-në vetëm në vitin 2006, kur ata formuan kabinetin e tyre të dytë. Gjatë fillimit të viteve 2000, partia dhe udhëheqësi i saj Nikolla Gruevski kundërshtuan dërgimin e dy rasteve të forcave të armatosura maqedonase në GJNPJ, duke argumentuar se vendi ishte nën sulm në vitin 2001 dhe se vetëm ata që provokuan konfliktin mund të ndiqen penalisht në Hagë.⁹⁹ Në vitin 2011, koalicioni VMRO-DPMNE dhe BDI mbrojtën një riinterpretim parlamentar të Ligjit për Amnisti, sipas të cilit katër raste në lidhje me UÇK-në, të cilat GJNPJ i ktheu në gjykatat maqedonase në vitin 2008, u refuzuan.¹⁰⁰

Tema e MKO nuk ka qenë një temë aq e rëndësishme e ndarjes mes partive politike shqiptare në Maqedoni. Që nga viti 2002, BDI, si "e vetmja parti që nuk mori pjesë në krijimin dhe negociatat që çuan në MKO", ka përvetësuar trashëgiminë e MKO dhe narrativën e UÇK-së dhe luftës së armatosur.¹⁰¹ Partia përdori përvjetoret e marrëveshjes për t'u pozicionuar si një parti që përfaqëson NATO-n dhe orientimin evropian, si një aleate nga kampi politik shqiptar që mund t'i besohet dhe si një parti që kërkon zgjidhjen e tensioneve ndëretnike në një mënyrë demokratike dhe paqësore. Ndërmjet viteve 2002 dhe 2006, BDI ishte e vetmja që organizoi ngjarje për nënshkrimin e MKO në vende

97 "Ramkovniot dogovor klucen stolb na uspešnoto rešenje na krizata – Trajkovski," *AI*, 13.08.2002.

98 Më shumë për këtë në: Naum Trajanovski, "The Three Memory Regimes of Ilinden Commemorations (2001-2018): A Prolegomenon to the Study of the Official Memory in North Macedonia," *Southeastern Europe* 44, no. 1 (2020): 28-52.

99 Të shihet, për shembull: "Nikola Gruevski, lider na VMRO-DPMNE: Tragedija e da im se sudi na branitelite," *Dnevnik*, 30.10.2003.

100 Irena Zdravkovska and Biljana Volchevska, "Analysis of the status of The Hague cases in North Macedonia," *BIRN*, 24.12.2020. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2020/12/24/how-north-macedonia-traded-justice-for-peace/>

101 Katerina Blaževska, "Frçkoski: Ohridskiот dogovor e uspešen, no ušte 'nerazbran,'" *DW Macedonia*, 14.08.2021. Në dispozicion në: <https://www.dw.com/mk/фрçкоски-охридскиот-договор-е-успешен-а-сè-уште-неразбран/a-58862983>

të ndryshme anembanë vendit. Vendndodhjet e ngjarjeve ishin kryesisht në pjesën perëndimore të vendit, e cila është multietnike dhe multikonfesionale.

Derisa politikanët maqedonas i bojkotuan këto ngjarje, morën pjesë përfaqësues diplomatikë dhe përfaqësues të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare. Prania ndërkombëtare në përkujtimore simbolizon mbështetjen për MKO dhe procesin e paqes në Maqedoni. Presidenti i SHBA Joe Biden e zyrtarizoi këtë pozicion në vitin 2021 me një Urdhër Ekzekutiv që parashikonte gjoba për individët që sabotojnë zbatimin e MKO, midis marrëveshjeve, kornizave dhe mekanizmave të tjerë rajonale në Ballkanin Perëndimor.¹⁰² Komuniteti ndërkombëtar luajti një rol të rëndësishëm në krijimin e imazhit të MKO në diskutet publike në Maqedoninë e Veriut.

Që nga viti 2006, ka pasur një institucionalitet të përvjetorit të MKO. Një nga ngjarjet e para ishte pritja që u organizua nga zyra e presidentit Branko Červenovski në Përvjetorin e Pestë të Marrëveshjes, disa ditë pas ceremonisë që e organizoi BDI. Pas kësaj, institucioni i posaçëm shtetëror, që në fillim quhej Sekretariat për zbatimin e MKO-së, morri organizimin e shënimit të përvjetorit. Sekretariati organizon ngjarje të ndryshme, duke përfshirë akademitë solemne, konferencat dhe pritjet. Vendimi i Kuvendit e ktheu Sekretariatin në Ministri për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive (MSPMNB), e cila mori përsipër organizimin e përvjetorëve. Që nga themelimi BDI dominon në këtë ministri.

Përkujtimet vjetore të 13 gushtit mbeten modeli më i suksesshëm i përkujtimeve të përbashkëta të çdo aspekti të konfliktit të armatosur në Maqedoni. Përkujtimi i përvjetorit të marrëveshjes së paqes fokusohet në perspektivat e përbashkëta të komuniteteve etnike dhe legjitimon vizionet e përbashkëta gjeopolitike të elitave politike. Perceptimi i qytetarëve për përvjetorët është më pozitiv sesa kur bëhet fjalë për ngjarjet e tjera përkujtimore në të cilat marrin pjesë përfaqësues të të dy grupeve etnike. Megjithatë, përpjekjet për të hapur përvjetorët për publikun e gjerë nuk kanë treguar sukses të ngjashëm. Shembulli më i fundit është vendimi i MSPMNB për të organizuar një festival muzikor më 13 gusht 2022 me idenë e promovimit të paqes ndëretnike. Festivali, i cili u zhvillua në sheshin

102 "Executive Order on Blocking Property and Suspending Entry Into The United States Of Certain Persons Contributing To The Destabilizing Situation In The Western Balkans," *The White House, Presidential Actions*, 08.06.2021.

Skënderbe në Shkup, mori një publicitet negativ edhe para fillimit, kur dy këngëtarë maqedonas anuluan performancën e tyre vetëm pak ditë para ngjarjes. Përveç kësaj, gjatë vetë ngjarjes, të pranishmit i kanë fishkëllyer prezantueses kur ajo i ka përshëndetur në gjuhën maqedonase. Pavarësisht kësaj, organizatorët e shohin ngjarjen si një "sukses" dhe kanë njoftuar planet për ta bërë festivalin një ngjarje vjetore.¹⁰³

103 Sanja Nikolovska, "Poln pogodok ili nepotrebna skapa proslava," Telma, 14.08.2022. Në dispozicion në: <https://telma.com.mk/2022/08/14/poln-pogodok-ili-nepotrebna-skapa-proslava/>.

5. Shënime përmbyllëse

Konflikti i armatosur i vitit 2001 është objekt i mosmarrëveshjeve në Maqedoninë e Veriut të sotme. Përkujtimet e episodeve të ndryshme të konfliktit të armatosur i japin formë këtyre debateve. Përkujtimet janë gjithashtu platforma për artikulumin dhe formatimin e diskurseve të ndryshme rreth konfliktit, parahistorisë së tij dhe marrëveshjes së paqes që i dha fund konfliktit. Projektet e shumta të memorializimit të aspekteve të ndryshme të konfliktit tregojnë për ekzistencën e ideve të ndryshme të rikrijimit të diskurseve dhe narrativave në hapësirën fizike. Ky punim argumenton se sistemi koordinativ i përkujtimit dhe memorializimit të konfliktit të vitit 2001 është ende i ndarë sipas linjave të dy bashkësive etnike dominuese në vend. Të dy komunitetet kanë zhvilluar kultura të veçanta të kujtesës të menaxhuar nga aktorë politikë dhe socialë. Përveç kësaj, çështja e mbështetjes shtetërore është pika e dytë më e rëndësishme e ndarjes ndërmjet aktiviteteve përkujtimore të dy komuniteteve. Megjithatë, shumë variabla të tjerë, si historitë lokale të marrëdhënieve ndëretnike, armiqësitë e armatosura dhe negociatat pas konfliktit përcaktojnë lëvizjet në sferën e kujtesës. Ky tekst ka hartuar këto pika të interseksionit ndërmjet dy domeneve etnike, përmes përcaktimit të katër modeleve dominuese të tejkalimit të përkujtimeve etnocentrike dhe projekteve të memorializimit në Maqedoninë e pasluftës.

6. Literatura

“Ulogata na megjuetničkiot dijalog vo procesot na odlučuvanje vo Opština Kumanovo.” In *Ohridski ramkoven dogovor: Studii na slučaj*, 137-142. Skopje: MCMS, 2011.

Ahmeti's Village: The Political Economy of Interethnic Relations in Macedonia. Skopje – Berlin, European Stability Initiative, 2002.

Anakioski, Dušan. “Kretanje zaposlenosti i promene u socijalnoj strukturi stanovništva SR Makedonije.” *Stanovništvo* 5-4 (1967): 293-304.

Bieber, Florian. “Power-Sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement.” In *Power-Sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement*, 7-40. Skopje: FES, 2008.

Brown, Keith S. “In the Realm of the Double-headed Eagle: Parapolitics in Macedonia 1994-9.” In *Macedonia: The Politics of Identity and Difference*, edited by J.K. Cowan, 122-139. London: Pluto Press, 2000.

Brunnbauer, Ulf. “Fertility, Families and Ethnic Conflict: Macedonians and Albanians in the Republic of Macedonia, 1944-2022.” *Nationalities Papers* 32, no. 3 (2004): 565-598.

Brunnbauer, Ulf. “The Implementation of the Ohrid Agreement: Ethnic Macedonian Resentments.” *Journal on ethno-politics and minority issues in Europe* 1, no. 1 (2002): 1-23.

Conflicting Perceptions: A study of prevailing interpretations of the conflict in Macedonia among Albanian and Macedonian communities. The Norwegian Helsinki Committee Report, 2003.

CONNEKT Country Reports. Framing Violent Extremism in the MENA Region and the Balkans: North Macedonia. European Institute of the Mediterranean, 2020.

CONNEKT Country Reports. Meso-Level Dynamics: Commemorations of the 2001 Macedonian conflict in Tetovo, North Macedonia. European Institute of the Mediterranean, forthcoming.

- Daskalovski, Zhidas. "The Independence of Kosovo and the Consolidation of Macedonia—A Reason to Worry?" *Journal of Contemporary European Studies* 16, no. 2 (2008): 267-280.
- Daskalovski, Zidas. "The Macedonian Conflict of 2001: Between Successful Diplomacy, Rhetoric and Terror." *Studies in Post-Communism*, Occasional Paper no. 7 (2004): 1-53.
- David, Lea. "Lost in Transaction in Serbia and Croatia: Memory Content as a Trade Currency." In *Replicating Atonement: Foreign Models in the Commemorations of Atrocities*, edited by M. Gabowitsch, 73-97. London – New York: Palgrave Macmillan, 2017.
- Di Lellio, Anna, and Stephanie Schwandner-Sievers. "The Legendary Commander: The Construction of an Albanian Master-narrative in Post-war Kosovo." *Nations and Nationalism* 12, no. 3 (2006): 513-529.
- Dimova, Rozita. "Consuming Ethnicity: Loss, Commodities, and Space in Macedonia." *Slavic Review* 69, no. 4 (2010): 859-881.
- Dimov-Markovska, Dona. "Ilustracija na primenata na ORD na lokalno nivo vo Tetovo i Tearce." In *Ohridski ramkoven dogovor: Studii na slučaj*, 131-136. Skopje: MCMS, 2011.
- Dokmanovikj, Mišo. *Sami na svoeto: Kratka istorija na makedonskata nezavisnost (1990-1993)*. Skopje: FES, 2021.
- Đureinović, Jelena. *Politika sećanja na ratove devedesetih u Srbiji: Istorijski revizionizam i izazovi memorijalizacije*. Beograd: Fond za humanitarno pravo, 2021.
- Engström, Jenny. *Democratisation and the Prevention of Violent Conflict: Lessons Learned from Bulgaria and Macedonia*. London – New York: Routledge, 2016.
- Friedman, Eben. "The Ethnopolitics of Territorial Division in the Republic of Macedonia." *Ethnopolitics* 8, no. 2 (2009): 209-221.
- Georgieva, Lidija, Naum Trajanovski, and John Wolffe. "Memory Regimes and Commemorative Practices of the Good Friday Agreement (1998) and the Ohrid Framework Agreement (2001)." In *Religious Diversity in Europe: Mediating the Past to the Young*, edited by R. Altnurme et al., 137-158. London: Bloomsbury Academic, 2022.

- Gligorov, Kiro. *Makedonija e sé što imame*. Skopje: Kultura, 2002.
- Ilievski, Zoran. *Ethnic Mobilization in Macedonia*. Bozen – Bolzano: European Academy, 2007.
- Ingimundarson, Valur. "The Politics of Memory and the Reconstruction of Albanian National Identity in Postwar Kosovo." *History and Memory* 19, no. 1 (2007): 95-123.
- Isemi, Mair, Petrit Menaj, and Rupi Osmani. *Izbor tekstovi za konfliktot od 2001 godina*. Skopje: FOOM, 2008.
- Istorija i apokrifi – demitologizacija na 2001: Debata*. Skopje: FOOM, 2010.
- Karajakov, Risto. "Macedonia's 2001 Ethnic War: Offsetting conflict. What Could Have Been Done but Was Not?" *Conflict, Security & Development* 8, no. 4 (2008): 451-490.
- Koktsidis, Pavlos I. "The Decision to Use Violence: Opportunity Structures and the Albanian Insurgency in the Former Yugoslav Republic of Macedonia." *Ethnopolitics* 18, no. 4 (2019): 383-405.
- Konečen izveštaj: Procenka na reintegracijata na raselenite lica i revitalizacija na regionite pogodeni od konfliktot vo Makedonija*. Skopje: MCMS – FAKT, 2003.
- Koneska, Cvete. *After Ethnic Conflict: Policy-making in Post-conflict Bosnia and Herzegovina and Macedonia*. Farnham: Ashgate, 2014.
- Kostovicova, Denisa, Ivor Sokolić, and Orli Fridman. "Below Peace Agreements: Everyday Nationalism or Everyday Peace?" *Nations and Nationalism* 26, no. 2 (2020): 424-430.
- Kulasic, Elmina. *Transitional Justice in Macedonia and its Relations with Democracy*. Skopje: KAS – CRPM, 2012.
- Ljatici, Veton. *Pregovorite za postignuvanje na Ohridskiot dogovor*. Skopje: FOOM, 2008.
- Lyon, Aisling. "Political Decentralization and the Strengthening of Consensual, Participatory Local Democracy in the Republic of Macedonia." *Democratization* 22, no. 1 (2015): 157-178.

- Mannergren Selimovic, Johanna. "Making Peace, Making Memory: Peacebuilding and Politics of Remembrance at Memorials of Mass Atrocities." *Peacebuilding* 1, no. 3 (2013): 334-348.
- Marks, John, and Eran Fraenkel. "Working to Prevent Conflict in the New Nation of Macedonia." *Negotiation Journal* 13, no. 3 (1997): 243-252.
- McQuaid, Sara Dybris, and Sarah Gensburger. "Administrations of Memory: Transcending the Nation and Bringing Back the State in Memory Studies." *International Journal of Politics, Culture, and Society* 32, no. 2 (2019): 125-143.
- Milosavljevski, Slavko, and Mirče Tomovski. *Albancite vo Republika Makedonija (1945-1995): Legislativa, politička dokumentacija, statistika*. Skopje: Studentski zbor, 1997.
- Mitevski, Mančo. *2001: Vojna so dve lica*. Skopje: Kultura, 2008.
- Mladenovski, Marjan. "Ramkovniot dogovor, etničkata distanca i multikulturalizmot: Fokus na opština Kumanovo." In *Ohridski ramkoven dogovor: Studii na slučaj*, 25-35. Skopje: MCMS, 2011.
- Muhic, Maja, Violeta Simjanovska, and Lea Linin. "Re-thinking cultural policy: From strategy to reality – intercultural dialogue and cultural diversity in Macedonia." In *Cultures and sustainable development at times of crisis*, 329-345. Belgrade: University of Arts in Belgrade, 2014.
- Neofotistos, Vasiliki P. *The Risk of War: Everyday Sociality in the Republic of Macedonia*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 2012.
- Neofotistos, Vasiliki. "Commemorations and the Re-invention of a City: Alternative Memories of the Past in North Macedonia." In *Cultures and Politics of Remembrance: Southeast European and Balkan Perspectives*, edited by N. Trajanovski et al., 89-96. Skopje: forumZFD – Institute of Ethnology and Anthropology – Institute of National History, 2021.
- Neofotistos, Vasiliki. "The Construction of Albanian Martyrdom in the Republic of Macedonia." *NCEEER Working Paper*, 2012.
- Ordanoski, Saso. "Lions & Tigers: The Militarisation of the Macedonian Right." In *The 2001 Conflict in FYROM – Reflection*, edited by J. Pettifer, 17-28. London: Institute of War & Peace Reporting, 2004.

- Ortakovski, Vladimir T. "Interethnic Relations and Minorities in the Republic of Macedonia." *Southeast European Politics* 2, no. 1 (2001): 24-45.
- Pavlaković, Vjieran. *Memoryscapes of the Homeland War*. Rijeka: University of Rijeka, 2022.
- Perica, Vjekoslav. *Pomirenje i posljedji dani. Balkanske nacije u mitovima i muzejima slave, stida i srama*. Beograd: Biblioteka XX vek, 2021.
- Phillips, John. *Macedonia: Warlords and Rebels in the Balkans*. London – New York: I.B.Tauris, 2004.
- Profile of internal Displacement: Macedonia*. Geneva: Norwegian Refugee Council – Global IDP Project, 2002.
- Radičeski, Neven. *Liberalizmot vo Makedonija (1966-1974)*. Skopje: Makedonika Litera, 2013.
- Ragaru, Nadège. "Macedonia: Between Ohrid and Brussels." *Cahiers de Chaillot* (2008): 41-60.
- Ragaru, Nadège. "The Political Uses and Social Lives of 'National Heroes': Controversies over Skanderbeg's Statue in Skopje." *Südosteuropa* 56, no. 4 (2008): 528-555.
- Reef, Paul. "Macedonian Monument Culture Beyond 'Skopje 2014.'" *Südosteuropa* 66, no. 4 (2018): 451-480.
- Rusi, Iso. "From Army to Party – The Politics of NLA." In *The 2001 Conflict in FYROM – Reflection*, edited by J. Pettifer, 1-16. London: Institute of War & Peace Reporting, 2004.
- Schwandner-Sievers, Stephanie. "The bequest of *Ilegalja*: contested memories and moralities in contemporary Kosovo." *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* 41, no. 6 (2013): 953-970.
- Sokalski, Henryk J. *Odrobina prewencji: Dorobek dyplomacji prewencyjnej ONZ w Macedonii*. Warszawa: Instytut Spraw Międzynarodowych, 2007.
- Spaskovska, Ljubica. "The fractured 'we' and the ethno-national 'I': the Macedonian citizenship framework." *Citizenship Studies* 16, no. 3-4 (2012): 383-396.
- Stamova, Marijana. *Albancite vo SR Makedonija prez prez poslednoto desetiletie v Titova Jugoslavija (1981-1991)*. Kyustendil – Gabrovo: Ivan Sapundžev, 2017.

- Stanoeski, Oliver. *Tranziciona pravda vo Republika Makedonija. Izveštaj za 2010-2011 godina*. Skopje: Centar za istraživanje i kreiranje politiki, 2013.
- Stawowy-Kawka, Irena. *Albańczyczy w Macedonii 1944-2001*. Kraków: Wydawnictwo UJ, 2014.
- Stefanovski, Ivan. "A Bottom-up Perspective on Peace and Security in North Macedonia: Turbulent Violent Past versus Uncertain Future?" In *Peace and Security in the Western Balkans: A Local Perspective*, edited by N. Džuverović and V. Stojarová, 70-87. London – New York: Routledge, 2023.
- Stokes, Gale. *The Walls Came Tumbling Down: The Collapse of Communism in Eastern Europe*. Oxford – New York: Oxford University Press, 1993.
- Trajanovski, Naum. "'Skopje 2014' Reappraised: Debating a Memory Project in North Macedonia." In *Europeanisation and Memory Politics in the Western Balkans*, edited by A. Milošević and T. Trošt, 151-177. London – New York: Palgrave Macmillan, 2021.
- Trajanovski, Naum. "The Three Memory Regimes of Ilinden Commemorations (2001-2018): A Prolegomenon to the Study of the Official Memory in North Macedonia." *Southeastern Europe* 44, no. 1 (2020): 28-52.
- Visoka, Gëzim. "Everyday peace capture: Nationalism and the dynamics of peace after violent conflict." *Nations and Nationalisms* 26, no. 2 (2020): 431-446.
- Voeni prikazni na prilepskite veterani od 2001*. Prilep: Mirovna akcija, 2020.

Kujtimi i konfliktit të armatosur në Maqedoni në vitin 2001:

MODELE TË PËRKUJTIMIT DHE MEMORIALIZIMIT

Botuesi:

Fondi për të Drejtën Humanitare
Dečanska 12, Beograd
www.hlc-rdc.org

Autor:

Naum Trajanovski

Redaktore:

Jelena Đureinović

Përkthimi:

Eda Radoman

Dizajni:

Milica Dervišević

Tirazhi:

100

Shtypshkronja:

Instant System, Beograd

ISBN-978-867932-125-1

